



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.400 prot.

Tiranë, më 05.03.2024

V E N D I M

Nr. 55, datë 05.03.2024

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”¹, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mori në shqyrtim ankesën me nr. 190, datë 26.09.2023, paraqitur nga znj. D.D (në vijim ankuesja) kundër z. D.B , Kryetar i Komisionit të Konkurrencës, duke pretenduar se është diskriminuar për shkak të gjendjes shëndetësore dhe për çdo shkak tjetër.

Pas shqyrtimit përfundimtar të ankesës së mësipërme, Komisioneri²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e paraqitur përpara Komisionerit, ankuesja parashtron se:

Unë D.D nga data 01.03.2005 deri në datën 17.07.2023, kam ushtruar detyrën e Sekretarit të Përgjithshëm në Autoritetin e Konkurrencës si nënpunësi më i lartë civil (TND) në këtë institucion. Gjatë ushtrimit të detyrës në këtë institucion në shtator të vitit 2021 Sekretari i Autoritetit të Konkurrencës, i cili drejtohej nga unë, realizoi një hetim në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit. Në përfundim të këtij hetimi nga Sekretariati i AK dhe unë si SP u propozua gjobitja e shoqërive që operonin në këtë treg për shkelje të nenit 3 dhe ligjit 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”. Komisioni i Konkurrencës me vendimin e datës 29.09.2021, me shumicën e votave të antarëve të këtij komisioni, z. D.B , znj.A.B , znj.L.M vendosi: Të mbajë në monitorim këtë treg edhe për 2022. Që nga ky moment 3 antarët e Komisionit të Konkurrencës të cilët nuk votuan për gjobë përkatësisht z.D.B , znj. A.B , znj. L.M kanë vijuar një marrëdhënie të tensionuar me mua si drejtuese e Sekretariatit.

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

Kjo marrëdhënie e tensionuar u përshkallëzua deri sa në datën 26.06.2023 nga ana e Kryetarit të Komisionit të Konkurrencës z. D.B më është kërkuar dorëheqja nga pozicioni i Sekretarit të Përgjithshëm në Autoritetin e Konkurrencës brenda 24 orëve në rast të kundërt me kërcënoi se do të fillonte procedimin disiplinor ndaj meje. Në shkelje të ligjit dhe në mungesën time, në cilësinë e eprorit direkt, pa dijenin time dhe pa pjesëmarrjen time filloi procedim disiplinor të paligjshëm në kundërshtim me dispozitat e ligjit 152/2013 “Për nënpunësin civil” dhe akteve të tejtra nënligjore në fuqi.

Të gjitha këto veprime janë kryer nga ana e Kryetarit të Komisionit të Konkurrencës z. D.B për shkak të pozicionit tim si Sekretar i Përgjithshëm dhe njëkohësisht drejtues i Sekretariatit në Autoritetin e Konkurrencës, kompetencat e të cilit janë të parashikuara në mënyrë të posaçme në nenin 27 dhe 29 të Ligjit nr.9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, duke nxjerrë në shkelje të ligjit akte si më posht vijon:

- 1. Njoftim për mbledhje të Komisionit të Konkurrencës nr.15, datë 27.06.2023, me një pikë rend dite “Për disa problematika të brendshme të Autoritetit të Konkurrencës”, ku në mungesë dhe në padijenin time të plotë për këtë proces KK ka kërkuar të fillojë procedimi disiplinor ndaj meje si Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Kërkesë e z. D.B në cilësinë e eprorit direkt nr.359, datë 27.06.2023 drejtuar Komisionit Disiplinor për fillimin e ecurisë disiplinore ndaj meje në cilësinë e Sekretarit të Përgjithshëm, akt i cili nuk më është bërë me dije dhe nuk më është vënë në dispozicion në shkelje të ligjit 152/2013 “Për nënpunësin civil” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.*
- 3. Me urdhërin nr.359/1, datë 27.06.2023 të z. D.B në cilësinë e eprorit direkt ka ngritur Komision Disiplinor për fillimin e ecurisë disiplinore ndaj meje, duke më bërë objekt të procedurave disiplinore pa shkaqe, duke më pezulluar nga puna pa shkak, në shkelje të ligjit, pa patur mundësinë të njihem apo jap pretendimet e mia, duke mos patur asnjë proces të rregullt ligjor dhe duke proceduar në mungesën time pasi në datën 27.06.2023 kam qënë me raport mjekësor dhe në padijeninë time të plotë për arsyet e këtij procedimi.*
- 4. Me shkresën nr.359/3 prot., datë 29.06.2023 të Komisionit Disiplinor me lëndë: Njoftim për fillimin e procedimit disiplinor, jam pezulluar nga detyra, akt për të cilin kam marrë dijeni në datë 03.07.2023, pasi i gjithë ky proces është realizuar në mungesën time për shkak të gjendjes time shëndetësore në datat 29 dhe 30 qershor 2023, fakt i cili provohet edhe nga raporti mjekësor.*
- 5. Në datë 03.07.2023 kam depozituar ankesën time pranë Komisionerit për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil për paligjshërinë e procesit të ecurisë disiplinore ndaj meje si nënpunësi më i lartë civil në Autoritetin e Konkurrencës.*
- 6. Me vendimin 67, datë 14.07.2023 Komisioneri për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil, ka trajtuar ligjshmërinë e procedurave administrative që janë ndjekur nga Komisioni Disiplinor pranë Autoritetit të Konkurrencës për nënpunësen D.D dhe në përfundim ka vlerësuar se të gjitha procedurat e ndjekura nga ana e Autoritetit të Konkurrencës, gjenden në kushtet e*

paligjshmërisë duke dhënë detyrimet përkatëse për z. D.B dhe për Komisionin Disiplinor të ngritur prej tij:

- Kryetari i Autoritetit të konkurrencës të anullojë Urdhërin nr.20 (359/1 prot.) datë 27.06.2023 “Për ngritjen e Komisionit të Disiplinës”, i ndryshuar me urdhrin nr.23 (359/1 prot.) datë 11.07.2023, për shkak të paligjshmërisë së konstatuar në përbërje të Komisionit të Disiplinës, duke rregulluar njëkohësisht pasojat e ardhura nga ky akt.
- Komisioni Disiplinor të anullojë aktin nr.359/3 prot., datë 29.06.2023, “Njoftim për fillimin e procedimit disiplinor”, ku përfshihet edhe vendimi i pezullimit nga detyra për nënpunësen D.D, si dhe çdo akt tjetër të nxjerrë nga ky organ.
- 7. Me shkresën nr.395/7 prot., datë 17.07.2023 me Lëndë: “Për pezullim për shkak të ligjit”, kam njoftuar Njësinë Përgjegjëse pranë Autoritetit të Konkurrencës dhe njëkohësisht Komisionin e Konkurrencës, se jam emëruar në një pozicion tjetër pune jashtë shërbimit civil, duke depozituar edhe aktin përkatës të emërimit.
- 8. Me shkresën nr.359/22 prot., datë 18.07.2023 Njësia Përgjegjëse pranë Autoritetit të Konkurrencës, ka konfirmuar: “Njoftimin e kryer nga ana ime dhe ka dalë me njoftim për: Konfirmimin e pezullimit nga shërbimi civil për nënpunësen D.D, bazuar në nenin 55/2 të Ligjit nr.152/2013 “Për nënpunësin civil” i ndryshuar, për një periudhë deri në dy vjet”.
- 9. Komisioni i Konkurrencës ka marrë Vendimin nr.1003, datë 18.07.2023, duke disponuar: “1. Largimin nga funksioni i Sekretares së Përgjithshme të Autoritetit të Konkurrencës, znj. D.D dhe përfundimin e marrëdhënies së saj të punës me Autoritetin e Konkurrencës. 2. Përfundimin e marrëdhënies financiare nga data 17.07.2023.”

Me daljen e akteve nr.359/22 prot., datë 18.07.2023 të Njesisë Përgjegjëse dhe Vendimit nr.1003, datë 18.07.2023 të Komisionit të Konkurrencës, ka përfunduar çdo lloj marrëdhënie e nënpunësit D.D me Autoritetin e Konkurrencës.

Në lidhje me shpjegimin e fakteve për diskriminimin e pretenduar, ankuesja parashtrohet :

1.Vendimi nr.67, datë 14.07.2023, i Komisionerit për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil, ka trajtuar ligjshmërinë e procedurave administrative që janë ndjekur nga Komisioni Disiplinor pranë Autoritetit të Konkurrencës për nënpunësen D.D, vendim i cili ka vlerësuar se të gjitha procedurat e ndjekura nga ana e Autoritetit të Konkurrencës, gjenden në kushtet e paligjshmërisë. Ky vendim nuk është zbatuar ende nga z. D.B , si dhe nga Komisioni Disiplinor të cilin ai e kryeson.

2. Me shkresën nr.395/7 prot., datë 17.07.2023 me lëndë: “Për pezullim për shkak të ligjit”, kam njoftuar Njësinë Përgjegjëse pranë Autoritetit të Konkurrencës dhe njëkohësisht Komisionin e Konkurrencës, se jam emëruar në një pozicion tjetër pune jashtë shërbimit civil, duke depozituar edhe aktin përkatës të emërimit.

3. Komisioni i Konkurrencës, patur parasysh aket e mësipërme, ka dalë me aktin administrativ Vendim nr.1003, datë 18.07.2023, duke disponuar: “1. Largimin nga funksioni i Sekretares së Përgjithshme të Autoritetit të Konkurrencës, znj. D.D dhe përfundimin e marrëdhënies së saj të

punës me Autoritetin e Konkurrencës. 2. Përfundimin e marrëdhënies financiare nga data 17.07.2023. Komisioni i Konkurrencës i cili drejtohet nga z. D.B ka marrë Vendimin 1003, datë 18.07.2023, duke cituar në mënyrë të gabuar me qëllim aktet e depozituara nga ana ime siç është kërkesa me lëndë: “Për pezullim për shkak të ligjit në zbatim të ligjit nr.152/2013 “Për nënpunësin civil”, i ndryshuar”. Në mënyrë të pavërtetë në pjesën “Vëren” të vendimit, Komisioni i Konkurrencës ka cituar se: “... ajo me dëshirë ka kërkuar ndërprerjen e marrëdhënies së punës në shërbimin civil dhe i bëhet me dije edhe Komisionit të Konkurrencës... për shkak të emërimit dhe fillimit të marrëdhënieve të punës në një pozicion jashtë shërbimit civil... ” fakt i cili është i pavërtetë. Kërkesa me nr.359/7 prot., datë 17.07.2023 dhe kërkesa nr.359/17 prot., datë 17.07.2023, depozituar pranë Autoritetit të Konkurrencës me lëndë: “Për pezullim për shkak të ligjit”, i njoftohet Njesisë Përgjegjëse pranë AK, në kuptim të ligjit nr.152/2013 “Për nënpunësin civil”, i ndryshuar dhe i bëhet me dije Komisionit të Konkurrencës. Në asnjë rast nuk kam kërkuar sa citohet në mënyrë të pavërtetë në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr.1003, datë 18.07.2023.

Për të gjitha sa sipër është e qartë se, z.D.B , si titullar i Institucionit në Autoritetin e Konkurrencës, për nga mënyra si janë ndjekur procedurat administrative, mban përgjegjësi që me veprimet e tij individuale nuk ka zbatuar ligjin duke më vendosur në kushtet e një trajtimi të padrejtë, të disfavorshëm duke cenuar rëndë të drejtat e mia dhe në veçanti integritetin tim profesional dhe të karrierës.

4. Me shkresën nr.359/30 prot., datë 11.08.2023 me lëndë “Në lidhje me pagën për periudhën 1 deri në 17 korrik i jam drejtuar Autoritetit të Konkurrencës pasi në mënyrë të padrejtë më ka ndaluar 50 % të pagës time si Sekretar i Përgjithshëm.

5. Me shkresën nr.359/31 prot., datë 21.08.2023 me lëndë “Njoftim për vijimin e procedimit disiplinor” z. D.B me kthen përgjigje se, procedimi disiplinor ndaj meje vazhdon, pa asnjë bazë ligjore dhe pa marrë parasysh faktin se unë nuk mbaj më pozicionin e Sekretarit të Përgjithshëm që prej datës 17.07.2023. Të gjitha këto veprime individuale të kryera nga z. D.B në shkelje të ligjit më kanë vendosur në kushtet e një trajtimi të padrejtë, diskriminues, duke u cenuar rëndë të drejtat e mia.

6. Me shkresën nr. 359/36 prot., datë 07.09.2023, me lëndë “Kthim përgjigje shkresës nr.359/31”, drejtuar Njesisë Përgjegjëse dhe Komisionit Disiplinor, bëj me dije se çdo veprim i kryer nga ana e tyre është në kundërshtim flagrant me Vendimin 67, datë 14.07.2023 të KMSHC, ligjin nr 152/2013 “Për nënpunësin civil”, i ndryshuar, Kodin e Procedurave Administrative si dhe ju rikujtoj se asnjë organ pranë këtij institucioni nuk ka asnjë lloj titulli dhe legjitimitimi për të disponuar apo komunikuar me personin tim.

7. Me shkresën nr.359/33 prot., datë 29.08.2023, vë në vëmendje të Njesisë Përgjegjëse në AK dhe Kryetarit të Komisionit të Konkurrencës z. B. se, nga ana e institucionit nuk është bërë asnjë

veprim për plotësimin e librezës time të punës nga personat përgjegjës, si dhe vendosja e vulës së institucionit për shkak se është dhënë urdhër verbal nga ana e z. D.B . Ende deri tani nuk kemi një veprim të kryer nga ana e institucionit lidhur me kërkesat e parashtruara nga ana ime. Me këto veprime të kryera në vijim nga ana e z. D.B janë në shkelje të ligjit 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ligjit 152/2013 “Për nënpunësin civil”, janë veprime intimiduese, diskriminuese ndaj meje dhe cenojnë rëndë të drejtat e mia.

8. Nga ana e z. D.B , më dërgohet korrespondencë për vijimin e procedurave disiplinore ndaj meje pranë institucionit ku unë punoj aktualisht, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, përkatësisht shkresat nr.359/21 prot., datë 17.07.2023 dhe shkresa nr.359/22, datë 18.07.2023, për të më vendosur në kushte të pafavorshme, për të më krijuar shqetësime në ushtrimin e detyrave të mia pranë ILD. Sjellje të tilla individuale nga ana e z. D.B , janë sjellje në dukje që shfaqin qëllimet për të intimiduar, diskriminuar dhe duke cenuar rëndë të drejtat e mia.

Ankuesja kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, kostatimin e diskriminimit të saj nga ana e z. D.B , Kryetar i Komisionit të Konkurrencës. Marrjen e masave të menjëhershme për ndalimin e shqetësimit dhe mospërsëritjen e situatave të ngjashme, të cilat cenojnë zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të LMD, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

LMD, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në një listë të hapur shkaqesh, duke garantuar në mënyrë të shprehur mbrojtje në lidhje me shkakun e gjendjes shëndetësore. Në nenin 1, të LMD përcaktohet: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD, të ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash.

Në Kreun II, të këtij ligji, parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. Në nenin 12/1/c, të LMD përcaktohet: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës.”

Bazuar në nenin 5, pika 1, të LMD, ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

1. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës nr.190 datë 26.09.2023, rezultoi se ajo nuk ishte e plotë për të vijuar më tej shqyrtimin e saj. Me anë të e-mailit datë 13.10.2023, ankueses iu kërkua plotësimi i ankesës. Me e-mail datë 15.10.2023, ankuesja depozitoi pranë Komisionerit informacionin plotësues në lidhje me ankesën.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të LMD, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

2. Me shkresën nr.1038/1 prot., datë 24.10.2023, Komisioneri njoftoi dhe kërkoi informacion nga z.D.B , Kryetar i Komisionit të Konkurrencës, në cilësinë e subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa. Në përgjigje të kësaj kërkesë, me shkresën nr.359/54 prot., datë 03.11.2023 (administruar pranë Komisionerit me nr. 1038/2 prot datë 06.11.2023), z. B. , ka kthyer përgjigje, duke parashtruar si vijon:

Z. B. , thekson se, duke qenë se pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është paraqitur një ankim personal ndaj tij, shpjegimet e mëposhtme janë po aq në cilësinë e tij personale, ndonëse në vetëdijen e tij të plotë të të qenurit Kryetar i Komisionit të Konkurrencës, në Autoritetin e Konkurrencës. Ai sqaron se, këto shpjegime nuk do të vijnë si një dokument i Autoritetit të Konkurrencës dhe nuk do të mbajnë vulën e institucionit.

I. Z. B. shprehet se, për shkak të informimit si jurist, trajtimeve të shumta në fushën e të drejtave të njeriut dhe të drejtave kushtetuese e eksperiencës së tij të gjatë si këshilltar në Gjykatën Kushtetuese, e pedagog në rang universitar i lëndës “E drejta Kushtetuese”, ka vetëdijen e plotë të konceptit të barazisë në dhe përpara ligjit, si dhe të diskriminimit, i kuptuar ky si një veprim me pasojë ndaj një individi ose si veprim afirmues.

Si nga literatura dhe nga praktika e GjEDNj apo gjykatave kushtetuese të shteteve anëtare të KiE, në rastet kur pretendohet diskriminim, aplikohet i njohuri “Testi i Diskriminimit”, duke qenë se jo çdo trajtim i ndryshëm përbën diskriminim, por vetëm: 1) trajtimet e diferencuara, 2) të cilat nuk mund të justifikohen në mënyrë të arsyeshme e objektive (shiko GjEDNj, vendimi *Fabris v. France*, 2013).

Nga pikëpamja e provave, GjEDNj, ndërsa shqyrton çështjet kur pretendohet diskriminimi, zbaton parimin *affirmanti incumbit probatio*, që do të thotë se kërkuesi duhet të provojë pretendimet e tij/saj. Gjykata zbaton standartin e provës “përtej çdo dyshimi të arsyeshëm” si një standart në të gjitha të drejtat e përcaktuara nga Konventa.

Legjislacioni shqiptar, Kodi i Procedurave Administrative, në nenin 82 "Barra e provës", pika 1, stipulon që:

"Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj."

Po aty, por vetëm në lidhje me (citoj nga pika 2) "[...] rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj."

GjEDNj ka pasur raste kur ka përmbysur barrën e provës nga akuzuesi tek i akuzuari, por kjo posaçërisht kur ngjarjet në fjalë janë tërësisht, ose në një pjesë të madhe, brenda dijës ekskluzive të autoriteteve (shiko ndër të tjera *Salman v. Turkey* [GC], 2000, § 100; *Angelova v. Bulgaria*, § 111; *Makuchyan and Minasyan v. Azerbaijan and Hungary*, 2020).

Gjatë gjykimit të rasteve të diskriminimit, GjEDNj zbaton testin e mëposhtëm:

1. A ka pasur dallime në trajtimin e personave në situata të ngjashme ose përkatësisht të ngjashme - apo dështim për të trajtuar ndryshe persona në situata relevante të ndryshme?
2. Nese po, a është i justifikuar objektivisht një ndryshim i tillë - apo mungesa e dallimit? Në veçanti, a. A ndjek një qëllim legjitim? b. A janë mjetet e përdorura në mënyrë të arsyeshme proporcionale me qëllimin e ndjekur?

Para së gjithash, kur parashtron një ankesë sipas nenit 14 të KEDNj, aplikanti duhet të tregojë se ai/ajo është trajtuar ndryshe nga një person tjetër ose grup personash të vendosur në një situatë përkatësisht të ngjashme, ose në mënyrë të barabartë me një grup personash të vendosur në një situatë përkatësisht të ndryshme (shiko *Carson dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 2010).

II.Rasti i ankimit të znj.D.D, pasi u analizua me seriozitet dhe vështirësi profesionale nga ana ime dhe e kolegëve të Komisionit - duke qenë se implikon në fakt edhe Komisionin e Konkurrencës (ndonëse unë në këto shpjegime nuk do të shprehem në emër të tyre), në lidhje me pretendimin për diskriminim arrij në konkluzionin se nuk mbështetet në asnjë provë. Ose të paktën, në shkresën tuaj me nr. 1 038/1 protokollin, datë 24. 10.2023 nuk listohet asnjë e tillë.

Nga kjo shkresë, rezultojnë thjesht disa pretendime, por jo prova. Pretendimi i parë lidhet me një vendimmarrje të Komisionit të Konkurrencës së datës 29.09.2021, periudhë kur unë isha në funksionin e anëtarit të Komisionit dhe periudhën kohore vijuese. Sipas znj.D. , që nga momenti kur (citoj): *"3 anëtarët e Komisionit të Konkurrencës, të cilët nuk votuan për gjobë përkatësisht z.D.B , znj.AB, znj.LM kanë vijuar **një marrëdhënie të tensionuar me ankuesen si drejtuese e Sekretariatit.** Sipas ankueses, kjo marrëdhënie e tensionuar u përshkallëzua, deri sa në datë 26.06.2023, nga ana e Kryetarit të Komisionit të Konkurrencës z.D.B , i është kërkuar dorëheqja nga pozicioni i Sekretarit të Përgjithshëm në Autoritetin e Konkurrencës brenda 24 orëve, në rast të kundërt e ka kërcënuar se do të fillonte procedimin disiplinor ndaj saj."* Theksimi me **bold** është imi (D.B.), për të sjellë në vëmendjen tuaj se, edhe sikur ky pretendim të jetë i vërtetë, marrëdhënia e tensionuar, apo mospëlqimi reciprok, apo mungesa e respektit profesional, apo mosdhënia e konfidencës me kolegun e punës, ndonëse nuk janë gjëra të këndshme, nuk kanë asnjë lidhje me diskriminimin. Sidoqoftë, siç do të provoj qartë në vijim, marrëdhënia mes meje e znj.D. ka qenë normale, për të mos thënë e mirë, deri në momentin kur znj.D. vendosi interesat e saj ekstra-ligjore mbi interesat e Autoritetit të Konkurrencës.

Pretendimi i dytë është se (citoj): *"Në shkëlqim të ligjit dhe në mungesën e ankueses, në cilësinë e eprorit direkt, pa dijeninë e saj dhe pa pjesëmarrjen e znj. D. , filloi një procedim disiplinor të paligjshëm në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil" dhe akteve të tjera ligjore në fuqi.[...]. gjithë ky proces ishte realizuar në mungesë të saj, për shkak të gjendjes shëndetësore në datat [..],fakt i cili provohet edhe nga raporti mjekësor.[..]. Ankuesja pretendon se, z. D.B , si titullar i institucionit në Autoritetin e Konkurrencës, për nga mënyra se si janë ndjekur procedurat administrative, mban përgjegjësi që me veprimet e tij individuale nuk ka zbatuar ligjin, duke e vendosur në kushtet e një trajtimi të padrejtë, të disfavourshëm duke cënuar rëndë të drejtat e saj dhe në veçanti integritetin e saj profesional dhe të karrierës."*

Çdo njeri me pak eksperiencë nga marrëdhëniet e punës, në administratën publike apo edhe gjetiu, e kupton që kemi të bëjmë me një situatë të rëndomtë pune ku, për shkaqe të drejta a të padrejta (që do të verifikohen në një proces gjyqësor), një drejtues apo disa drejtues (në rastin tonë anëtarët e Komisionit të Konkurrencës), kanë mbajtur një qëndrim të caktuar ndaj punonjësit/punonjëses së tij.

Praktikisht, znj. D. është larguar nga shërbimi civil pas një procesi disiplinor, i cili sipas Autoritetit të Konkurrencës është zhvilluar në respekt të ligjit dhe ku një Komision Disiplinor, i kryesuar prej meje si titullar i institucionit dhe i përbërë nga anëtarë sipas parashikimeve ligjore,

pasi analizuan veprimet dhe mosveprimet e znj.D. , morën në mënyrë unanime vendimin e mësipërm.

Bashkëngjitur me këtë shkresë ju do të gjeni edhe vendimin përkatës të Komisionit Disiplinor ku renditen veprimet e mosveprimet që çuan në largimin nga shërbimi civil të znj.D. , por shkurtimisht -për të dhënë kontekst, po përshkruaj disa prej tyre.

Znj. D. , megjithëse ishte në dijeni të plotë të një ankimi të paraqitur nga një ndërmarrje në Autoritetin e Konkurrencës (AK) në vitin 2019, nuk ia bëri me dije këtë fakt Komisionit të Konkurrencës kur, po e njëjta ndërmarrje, e ripërsëriti ankimin në vitin 2022. Komisioni i Konkurrencës, në padijeni të persistencës së ndërmarrjes (çka tregon interes të vazhdueshëm), e konsideroi interesin e saj si të rënë në dekadencë dhe nuk e gjobiti ndërmarrjen tjetër, e cila kishte cenuar konkurrencën në tregun përkatës. Fakti i ekzistencës së ankimit të vitit 2019 erdhi në dijeninë time kur përfaqësuesit e AK në gjyqin civil, u vunë përballë provës shkresore (ankim i protokolluar nga AK) nga ana e ndërmarrjes ankuese/paditëse. Pasi u njoftova (ditët e para të Qershorit), urdhërova që të kërkohej në protokollin e AK për ankimin e 2019, i cili u gjet dhe mbante mbi vete dy shënime, atë të Kryetares L. drejtuar znj.D. dhe të kësaj të fundit drejtuar z.I.R, atëkohë Drejtor Juridik i AK. Në vitin 2022, kur kjo çështje u hetua për herë të parë nga AK (çuditërisht nuk ka pasur asnjë hetim për ankimin e parë në 2019!), i vetmi person ende në detyrë në AK dhe në dijeni të ankimit të vitit 2019 ishte znj.D. . Në ushtrim të detyrës, e ndava këtë informacion me kolegët e Komisionit të Konkurrencës (KK), të cilët më kërkuan nisjen e menjëhershme të procedimit disiplinor ndaj znj.D. , pasi ajo nuk gëzonte më besimin e tyre. Në fakt, pas kësaj ngjarje, diku në mars-prill 2023, marrëdhënia e të gjithë anëtarëve të KK me znj.D. u acarua dhe raportimet e saj si S.P përpara Komisionit u shndërruan në gati procese hetimore, ku hulumtohej për çdo detaj, pasi anëtarët e Komisionit nuk besonin më te znj.D. dhe te mënyra sesi ajo prezantonte faktet e dosjeve hetimore. Personalisht, megjithëse i dyzuar, jam përpjekur ta zbus situatën, me dëshirën për t'i dhënë D. beneficin e dyshimit....

ii. Në pranverën e këtij viti, nga punonjësit e Drejtorisë Juridike jam vënë në dijeni (dhe rastet po shtohen tani që znj.D. është larguar nga detyra) për një vendim me gjobë të Komisionit të Konkurrencës, ku gjoba ishte shndërruar në titull ekzekutiv, por vetë gjoba nuk ishte mbledhur, megjithëse vendimi ishte i vitit 2018(!). Sipas punonjësit, znj.D. i kishte kërkuar ta mbante praktikën në sirtar. Që gjoba ishte e pa mbledhur prej disa vitesh, ky është fakt i padiskutueshëm, sikundër është fakt i padiskutueshëm edhe që ndërmarrja X kishte bërë pranë nesh një ankim në vitin 2019. Këto janë shkresërisht të provueshme përtej çdo dyshimi. Sipas Komisionit Disiplinor, edhe sikur të bëhet fjalë për harresa(!), këto janë me pasoja shumë të rënda për Autoritetin e Konkurrencës dhe në cilësinë time personale si Kryetar, ju them se e vunë në dyshim të fortë besimin tim te integriteti i znj.D. .

iii. Çfarë e theu përfundimisht këtë besim, ishte shtrembërimi absolut dhe tjetërsimi i rrethanave të faktit nga znj.D. në lidhje me një tjetër hetim të AK, mbi një përqendrim i cili, në kundërshtim me ligjin, nuk na ishte njoftuar nga palët që mbartnin detyrimin për të bërë

njoftimin në Autoritet. "Interpretimi" i ligjit për këtë çështje nga znj.D. jo vetëm që ishte haptazi i gabuar e jo-profesional, por ishte i qëllimshëm për të favorizuar ndërmarrjet të cilat kishin shkelur ligjin e që do të gjobiteshin për këtë. Në 20 vite Autoritet e disa qindra raste përqendrimesh, znj.D. nuk arriti të sillte asnjë precedent ku ligji të ishte "interpretuar"(!) në atë mënyrë (absurde), megjithëse iu kërkua nga ana ime, me dëshirën për t'ia lehtësuar pozitën. Biseda mes meje dhe znj.D. ndodhi në datën 26.06.2023. Unë kisha marrë dijeni për këtë tjetërsim të fakteve e të ligjit një ditë më parë dhe po atë ditë ua kisha bërë me dije edhe kolegeve anëtarë të Komisionit të Konkurrencës. Znj.D. nuk ndodhej në Shqipëri prej një javë, ku me lejen time i ishte bashkëngjitur bashkëshortit të saj, në një udhëtim pune të këtij të fundit

Sa më lart janë fakte të provueshme e të provuara, jo pretendime shpifje.

Në ankim citohet edhe një bisedë mes meje e znj.D. , e ndodhur në zyrën time, në datë 26.06.2023, ku, sipas znj.D. , nga ana ime, *"i është kërkuar dorëheqja nga pozicioni i Sekretarit të Përgjithshëm në Autoritetin e Konkurrencës brenda 24 orëve, në rast të kundërt e ka kërcënuar se do të fillonte procedimin disiplinor ndaj saj"*.

Unë nuk po ia lejoj vetes të ndaj me ju justifikimet e znj.D. në atë bisedë se përse ajo mbante prej vitesh gjoba të paekzekutuara të X e Y biznesi, apo se përse znj.D. vendosi që, pas 18 vitesh punë si SP në Autoritetin e Konkurrencës, të adoptojë një interpretim 100% të kundërt me praktikën 20 vjeçare dhe ligjin "Për mbrojtjen e konkurrencës" në lidhje me përqëndrimet, apo nëse dorëheqja për znj.D. ishte më e favorshme sesa largimi nga shërbimi civil në lidhje me fakte 100% të provueshme e të provuara. Kini parasysh se, znj.D. në asnjë rast, si në ankimin tek ju e si në KMSHC, nuk guxon të analizojë thelbin e problemit, por merret vetëm me procedurën, praktikisht përbërjen e Komisionit Disiplinor.

III.Le të flasim pak për pretendimin për "diskriminim" që prej datës 29.09.2021(!) kur unë bashkë me dy kolege anëtare të KK lamë në pakicë ish-Kryetaren L. dhe një anëtar tjetër, e deri në përfundim të procesit disiplinor, në datë 28.09.2023, kur me vendim të Komisionit Disiplinor u vendos "largimi nga shërbimi civil për znj.D.D".

III.1. Unë e kam marrë funksionin e Kryetarit të KK në datë 9.12.2021, pra vetëm pak më shumë se 1 muaj pas vendimit të KK të datës 29.09.2021. Gjatë ditëve që pasuan atë vendimmarrje të tensionuar, për shkak të situatës jo-normale që krijoi ish-Kryetarja, unë dhe dy koleget e tjera ose nuk shkonim në punë ose mbylleshim në zyrë dhe nuk kishim asnjë komunikim me punonjësit e AK. Kjo edhe për faktin e shëmtuar se punonjësit nuk guxonin të na flisnin. Pas kalimit në detyrën e Kryetarit të KK në 6.12.2021, bashkëpunimi im si titullar me znj.D. si SP ka qenë tepër normal dhe profesional. Afërmendsh, rrethanat personale/familjare të saj si bashkëshorte e z.B. D. luajtën rolin e tyre në këtë pikë.

Për ta ilustruar me fakte lehtësisht të provueshme, ju bëj me dije se diku 3 muaj pas ardhjes në detyrën e re, në një shkresë të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme që mban datën

31.03.2022 ku njoftoheshim për një aktivitet në Bruksel, unë si titullar kam vënë shënimin "Znj.D. , të sigurohet përfaqësimi nga ju dhe M.". Përsa kohë që shërbimet jashtë shtetit janë ende forma të vlerësimit e stimulimit të punonjësve, është e qartë për këdo se znj.D. nuk mund të shkonte "jashtë shtetit" pa dëshirën e mirë të drejtuesit të institucionit, pavarësisht pozicionit të saj. Kur vjen puna te një institucion me një Komision Kolegjial të përbërë nga 5 anëtarë (4 përveç Kryetarit) ku të gjithë duan të shkojnë në aktivitete të tilla, dashamirësia në përzgjedhje evidentohet edhe më shumë. Sjell në vëmendje se znj.D. nuk mbajti ndonjëherë ndonjë fjalë a referat në aktivitete ndërkombëtare, kështu që argumenti se "ka shkuar për shkak të funksionit" nuk qëndron. Ftesat nuk kanë qenë asnjëherë personale për atë, pasi gjithmonë vinin e vijnë në emrin e Kryetarit.

Po me propozimin tim, znj.D. përfaqëson AK në një tjetër aktivitet, në Dhjetor 2022, në Paris. Të përcaktuarit e znj.D. si përfaqësuese e AK në aktivitete jashtë Shqipërisë (përtej faktit problematik se edhe anëtarët e KK dëshironin të shkonin), krijonte edhe një problem tjetër: znj.D. duhet të shkonte e shoqëruar me dikë që fliste anglisht. Nëse shikoni Autorizimin për Shërbim Jashtë Vendit, do të vëreni se ajo është shoqëruar po nga znj.M., e përzgjedhura e saj. A e kuptoni sa shumë ia kam plotësuar dëshirat znj.D. që, jo vetëm të shkonte në Paris, por sërish me të njëjtën shoqëruese si edhe në Bruksel! Natyrisht që ka shkuar sepse ishte SP e institucionit, kjo është e pamohueshme. Pyetja që e ka përgjigjen brenda është "a do të shkonte nëse unë do isha duke e diskriminuar?"

Në 6-10 Mars 2023, bashkë me një grup punonjësish të AK, unë dhe znj.D. u paraqitëm përpara përfaqësuesve të Komisionit Europian, në kuadër të procesit të bilateral screening. Pa asnjë dyshim që znj.D. , si krahu im i djathtë do ishte aty krahe meje. Pas kësaj dolëm dhe festuam. Unë dhe zonja D. , siç mund të shihet, jemi në harmoni dhe një marrëdhënie shumë të mirë.

Pak kohë pas kthimit nga Brukseli, erdha në dijeni të faktit (të provuar) se një gjobë e vendosur nga Komisioni i Konkurrencës për një shoqëri biznesi në vitin 2018 rezultonte ende e pavjelë nga AK. Inspektori që ma referoi si shqetësim më tha edhe se znj.D. i kishte kërkuar ta mbante dosjen në sirtar. Nuk e ndava me asnjëri këtë, duke qenë se bëhej fjalë për një bisedë mes vetëm dy personash, mes të cilëve znj.D. prevalonte në hierarki dhe nivel bashkëpunimi me mua. Nga ana tjetër, ishte detyrë e znj.D. të përkujdesej që vendimet e KK të zbatoheshin.

Por "harresat" e znj.D. po bëheshin palë, në një kohë kur memoria e saj vlerësohej vazhdimisht dhe ajo, me humor dashamirës, konsiderohej si kompjuteri i AK.

Sidoqoftë, në 2 Qershor 2023, pra vetëm 24 ditë përpara prishjes së marrëdhënies, unë kam firmosur urdherin nr.19 (nr.312 protokollit të AK) ku vendos që znj.D. (sërish me bashkëshoqëruesen/përkthyesen M.) të shkonte në shkollën verore në Rodos, Greqi, në programin ekzekutiv CALEP. Nëse do të kishte ndonjë armiqësi mes nesh nuk bëhej fjalë që ta dërgoja për një javë në "ishullin e Diellit"; destinacioni më i vizituar në Greqi; në Korrik; me të gjitha shpenzimet e paguara. Nuk do habitesha po të më thoni në këtë pikë se, do të donit edhe ju

të ishit po kaq të diskriminuar sa znj.D. , e cila me këtë ankesën pranë jush, ose shpif, ose seriozisht nuk e ka idenë se çfarë d.m.th. "trajtim i ndryshëm, me pasoja të pandershme e të padrejta, ndaj një personi, i cili bie në një kategori të caktuar, për shkak të përkatësisë në këtë kategori, qoftë kjo me bazë etnike, gjinore, shëndetësore apo tjetër".

III.2 Në datë 26 Qershor 2023, i kërkova znj.D. të më shpjegonte përse në lidhje me një çështje të caktuar, detyrimin për të njoftuar përqëndrimin (e pa njoftuar) ia kishte ngarkuar ndërmarrjes "X" dhe jo asaj që parashikonte ligji, me pasojë minimizimin ekstrem të gjobës. Znj.D. propozonte në fund të hetimit një gjobë simbolike prej 100.000 lek, ndërkohë që po të aplikoheshin formula sipas ligjit, gjoba shkonte mbi 3 milion euro (!). Argumentet e znj.D. ishin ekstra-ligjore dhe haptazi jo-profesionale. Në vijim i kërkova llogari edhe për shkeljet e tjera të shpjeguara më herët. Znj.D. për njërin rast heshti ndërsa për tjetrin më ktheu një përgjigje që, me eufemizëm po e cilësoj si "të pa mbështetur në ligj".

Për rrethana personale, të panevojshme për t'i shpjeguar këtu, mora përsipër t'i jap si mundësi dorëheqjen, si formë e largimit të butë, duke qenë se nga ai moment besimi im te znj.D. nuk ekzistonte më dhe ne nuk mund të punonim më bashkë. Integriteti profesional i znj.D. në sytë e mi pas kësaj ishte zero. Them mora përsipër, pasi në fakt pranimi i dorëheqjes apo çdo veprim tjetër që lidhet me marrëdhënien e punës të Sekretarit të Përgjithshëm të AK është në kompetencë të Komisionit të Konkurrencës dhe jo posaçërisht të Kryetarit të Komisionit. Ligji nr. 9121, datë 28.7.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" në nenin 27 "Sekretariati i Konkurrencës" parashikon se "Sekretariati drejtohet nga Sekretari i Përgjithshëm, i cili zgjidhet nga Komisioni."

Duke qenë se nuk pati asnjë zhvillim, të nesërmen në datë 27 Qershor, ora 11:00, thirra kolegët anëtarë të KK dhe iu bëra me dije se, nën përgjegjësinë time, i kisha kërkuar znj.D. dorëheqjen si SP e AK për veprime e mosveprime të saj, të kryera në kundërshtim me ligjin. Mora mbështetjen e anëtarëve të KK, të cilët në vijim kërkuan që këto veprime e mosveprime të analizoheshin nga një Komision Disiplinor (KD) i ngritur me nëpunës civilë të AK dhe të kryesuar prej meje e jo prej dikujt tjetër, duke qenë se znj.D. ishte punonjësjë më e lartë në shërbimin civil në Autoritet dhe KD nuk kishte si të drejtohej nga një vartës i saj.

Znj.D. nuk u paraqit në zyrë atë ditë. Rezulton një "Raport për paafësi të përkohshme në punë", ku mjekja E.L vlerësoi se znj.D. ka nevojë për 2 ditë pushim, për një diagnozë të caktuar. Personalisht kam gjithë tendencën të besoj se znj.D. nuk është ndjerë mirë në datë 27 Qershor pasi edhe unë, në rrugëtimin tim profesional kam kaluar situata kur, për shkak të rrethanave (për fat asnjëherë të krijuara nga veprimet apo mosveprimet e mia, si në rastin e znj.D.), kam dhënë dorëheqjen duke ndërprerë marrëdhënien e punës. Nuk jam ndjerë mirë, kuptohet.

Në mbledhjen e datës 27 Qershor të Komisionit Disiplinor u vendos që dëgjesa e znj.D. do të bëhet në datën 07.07.2023.

Në datë 07.07.2023, znj.D. nuk u paraqit në AK, por dërgoi një "Raport për paaftësi të përkohshme në punë", të datës 07.07.2023, ku mjekja E.L vlerëson se, znj.D. ka nevojë për (vetëm) 1 ditë pushim, për po të njëjtën diagnozë. Koincidenca është e pazakontë, por nuk do të komentoj më tej, duke e lënë në integritetin profesional të mjekes. Sidoqoftë, mendoj të theksoj se bëhet fjalë për një gjendje shëndetësore e cila është e përkohshme dhe që, në vlerësimin e mjekes, meriton vetëm 1 ditë pushim.

Komisioni Disiplinor, i përbërë nga 5 anëtarë dhe i kryesuar nga unë, i pranoi kërkesat e znj.D. , të dërguara me shkresën e firmosur prej saj me nr.359/7, datë 03.07.2023 të protokollit të AK, ku nga znj.D. pranohej se kishte marrë dijëni për nisjen e një procedimi disiplinor dhe se kishte marrë dokumentacion bashkëlidhur njoftimit, por kërkonte edhe dokumente të tjera. KD vendosi që materialet e listuara në kërkesën e znj.D. t'i vihen në dispozicion (përveç rregjistrimeve audio, të cilat do t'i jepeshin të zbardhura).

Data e re për dëgjuesën e znj.D. , ku ajo do të mund të bënte të gjitha prapësimet u la data 14.07.2023. Në datë 14.07.2023, znj.D. PËRSËRI nuk u paraqit në AK, por dërgoi një "Raport për paaftësi të përkohshme në punë", të datës 14.07.2023, ku mjekja E.L vlerëson se, znj.D. ka nevojë për (vetëm) 1 ditë pushim, për po të njëjtën diagnozë. Nuk ia vlen të komentosh për koincidençën ! Sidoqoftë, Komisioni Disiplinor vlerësoi që znj.D. t'i jepej NJË TJETËR MUNDËSI, në datë 27.07.2023, megjithëse ligji praktikisht nuk e parashikon këtë dhe kjo ishte një dashamirësi e tepruar nga ana e KD. Znj.D. nuk u paraqit as në datë 27.07.2023 për tu dëgjuar nga Komisioni Disiplinor.

Dua të sjell në vëmendjen tuaj se, megjithëse korrespondeca jonë për ftesat është dërguar me postë në të njëjtën adresë që përdor edhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, letrat tona ktheheshin nga Posta Shqiptare, pasi zarfi refuzohej nga znj.D. Edhe në rastet ku shkresat (njoftime apo dokumentacion) janë dërguar dorazi me punonjës të AK, znj.D. nuk ka firmosur në regjistrin përkatës.

Mbledhja e radhës u la në datë 08.09.2023 dhe kjo iu njoftua gjithashtu znj.D. .

Ndërkohë, znj.D. ka dërguar disa shkresa pranë AK, madje në datë 31 Gusht ka qenë në zyrat e AK për të plotësuar Vlerësimet e Punës (të prapambetura) dhe nuk ka depozituar asnjë prapësim në lidhje me shkeljet e ligjit me të cilat e kishte ngarkuar Komisioni Disiplinor. Në shkresën e datës 29.08.2023, znj.D. kërkon që kur të jetë në ambjentet e AK të mos intimidohet nga ana e Kryetarit të Komisionit të Konkurrencës apo nga çdo person tjetër(!). Mesa duket, kishte nisur të përpunonte idenë për këtë ankim pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Në çdo rrethanë e pa asnjë lidhje me këtë pretendim abuziv e të pabazë, unë nuk isha fare në Tiranë atë fund Gushti.

Znj. D. nuk u paraqit përsëri as në datë 08.09.2023 përpara Komisionit Disiplinor. Këtë radhë,

për fat ishte mirë me shëndet.

E vetëdijshme për mbledhjen e datës 08.09.2023 të Komisionit Disiplinor, një ditë më parë, në 07.09.2023, znj.D. dërgoi në AK një letër ku qartësisht lë të kuptohet se nuk e njeh ekzistencën e Komisionit Disiplinor (e etiketon me tallje "i vetëquajturi Komision Disiplinor"). Edhe në këtë letër, znj.D. , ftesën për tu paraqitur përpara Komisionit Disiplinor dhe për shpalosur pretendimet/prapësimet e rastit e konsideron "tentativë e pastër intimidimi dhe diskriminimi". Për mua si jurist e pastër këtu më së paku është se znj.D. nuk e ka fare konceptin se çfarë d.m.th. diskriminim në kuptim të legjislacionit shqiptar dhe atij konventor.

Znj.D. , mesa duket në pamundësi të plotë për tu përballur me shkeljet e veta të ligjit, tenton të përfitojë nga përdorimi i Komisionerit për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil, sipas të cilit përbërja e Komisionit Disiplinor është në kundërshtim me ligjin. Sipas KMSHC, Komisioni Disiplinor nuk duhej të kryesohej nga Kryetari i AK! Ky interpretim i legjislacionit për shërbimin civil nga ana e KMSHC, në vlerësimin e Komisionit të Konkurrencës është absurd, pasi e çon numrin e anëtarëve të KO nga 5 që parashikon VKM përkatëse në 9. Akoma më tej, ka vendimmarrje gjyqësore ku në raste të ngjashme (shkarkimi i SP të Këshillit të Lartë të Prokurorisë), Komisioni Disiplinor është udhëhequr nga titullari i KLP, z.Gent Ibrahimimi. Përbërja e KO të KLP në atë rast është goditur gjatë ankimit në gjykatën administrative nga SP e shkarkuar dhe nuk është gjetur në kundërshtim me ligjin në atë rast.

Në mbledhjen e datës 28.09.2023, pra më shumë se 3 muaj nga nisja e procedurës disiplinore, pasi ezauroi çdo hapësirë ligjore dhe i dha znj.D. çdo mundësi për të ardhur e paraqitur prapësimet e saj në lidhje me shkeljet për të cilat akuzohej, Komisioni Disiplinor, me unanimitet vendosi "Largimin nga shërbimi civil për znj.D.D".

Neni 1 i ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", parashikon se "ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me [...] gjendjen shëndetësore, [...] ose me çdo shkak tjetër."

Neni 3 (po aty) jep përkufizimin dhe sqaron se: "Diskriminim" është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi".

Fjalët kyç, edhe në kuptim të testit të diskriminimit sipas jurisprudencës së GjEDNj, janë:

1. Ekzistenca reale (jo thjesht e pretenduar dhe imagjinare) e çdo dallim, përjashtimi, kufizimi ose preference;
2. Që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit të të drejtave;

3. Në të njëjtën mënyrë me të tjerët.

Këto elemente janë kumulative dhe duhet të plotësohen njëkohësisht. Me fjalë të tjera, fillimisht duhet të identifikohet një dallim, apo përjashtim, apo kufizim, apo preferencë, i cili ka si qëllim apo pasojë kufizimin e një të drejte kushtetuese dhe/ose konventore, e drejtë e cila praktikisht ushtrohet/gëzohet nga individë të tjerë të cilët nuk bien në kategorinë me bazë etnike apo gjinore apo shëndetësore, etj., me individin që pretendon diskriminimin. Nëse ky dallim apo përjashtim identifikohet, atëherë, që të ndodhemi përpara diskriminimit në kuptim të ligjit, dallimi/përjashtimi duhet të jetë i pajustificueshëm në mënyrë të arsyeshme e objektive (*shiko GjEDNj, vendimi Fabris v.France, 2013*).

Në rastin në analizë, znj.D. , përveçse si retorikë, nuk ka arritur të identifikojë asnjë dallim/trajtim të diferencuar që i është bërë posaçërisht asaj, me qëllim apo pasojë ushtrimin e një të drejte kushtetuese. Në qoftë se me "të drejtë kushtetuese të kufizuar" znj.D. i referohet ndërprerjes së marrëdhënies së punës apo largimit nga shërbimi civil, ky do të ishte jo thjesht një interpretim shumë i gjerë i konceptit, por praktikisht një interpretim i cili, nëse do të adoptohej nga Komisioneri, do të mjaftonte për të identifikuar çdo të larguar nga puna, madje çdo të dënuar (administrativisht dhe/ose penalisht) si *a priori* të diskriminuar.

Siç kam sqaruar hollësisht më lart (në respekt të institucionit tuaj, të këtij që drejtoj dhe të emrit tim) znj.D. ka kryer veprime e mosveprime të cilat janë të provueshme përtej çdo lloj dyshimi se përbëjnë shkelje të legjislacionit për shërbimin civil, të ligjit "Për mbrojtjen e konkurrencës" dhe Kodit të Procedurave Administrative. Aspektet procedurale të përbërjes së Komisionit Disiplinor që vendosi "largimin nga shërbimi civil" janë tashmë pjesë e shqyrtimit gjyqësor administrativ, duke qenë se vendimet e KMSHC që e konsiderojnë përbërjen e KD si të paligjshëm janë paditur nga ana e Autoritetit të Konkurrencës në gjykatën administrative. Ndërkohë edhe znj.D. ka depozituar në këtë gjykatë një kërkesë padi.

Nga ana e Komisionit Disiplinor u bë e pamundura që znj.D. t'i krijohej çdo lehtësi në mënyrë që ajo të njihej me shkeljet për të cilat akuzohej, të kishte në dispozicion çdo dokument që ajo vlerësonte të nevojshëm për të siguruar mbrojtjen e saj dhe për tu dëgjuar.

Si profesionist, e them me bindje se në kuptim të ligjit, praktikës ndërkombëtare dhe të rrethanave të provueshme, pretendimet e znj.D. nuk arrijnë të identifikohen si trajtim i diferencuar apo kufizim a pengim në ushtrim të një të drejte të ligjshme. Sa i takon kufizimit për shkak të gjendjes shëndetësore, kjo pastaj është haptazi e papranueshme dhe keqkuptim, me dashje ose jo, i konceptit.

Sa më takon mua personalisht, vlerësoj se me znj.D. kam pasur marrëdhënien me miqësore në krahasim me çdo sekretar të përgjithshëm tjetër në institucione të tjera ku kam ushtruar detyrën

e titullarit. Arsyeshëm, nuk kemi detyrimin si titullarë të mbajmë me pekule vartësit e bashkëpunëtorët, pavarësisht mbiemrave përkatës. Aq më pak t'i lejojmë ata të shkelin ligjin. Detyrimin për të mbajtur respektin dhe emrin e mirë në rradhë të parë është i vetë personit!

4. Me shkresën nr. 1038/3 prot., datë 09.11.2023, ankueses iu komunikuan parashtrimet dhe aktet e depozituara nga z. B. . Me shkresën nr.1038/4 prot., datë 06.12.2023 ankuesja ka depozituar kundërshtimet e saj, ku ndër të tjera parashtron:

Kjo letër nuk bën gjë tjetër, veçse konfirmon edhe më shumë mënyrën e sjelljes diskriminuese, arrogancën, tentativat e vazhdueshme të intimidimit të z. B. , qoftë në cilësi personale apo të Kryetarit të Komisionit të Konkurrencës. Do ta konsideroja të tepërt çdo koment në lidhje me këto të ashtuquajtura shpjegime, sepse gjuha e përdorur flet qartë më shumë se çdo provë apo element tjetër. Por për shkak të raportit me të vërtetën, më duhet të nënvizoj disa pasazhe në vijim.

- Në paragrafin e dytë të faqes 3, citoj *e kupton që kemi të bëjmë me një situatë të rëndomtë pune...*

Konfliktet e sajuara në punë dhe presioni mbi Sekretarin e Përgjithshëm me qëllim vendosjen e kontrollit mbi Sekretariatit nuk mund të jenë situatë e rëndomtë pune.

- *Në lidhje me paragrafin e fundit të faqes 3, “ Në fakt, pas kësaj ngjarje, diku në mars-prill 2023, marrëdhënia e të gjithë anëtarëve të KK, me znj. D. u acarua dhe raportimet e saj si SP përpara Komisionit u shndërruan në gati procese hetimore ku hulumtohej për çdo detaj, pasi anëtarët e Komisionit nuk besonin më te znj. D. dhe te mënyra sesi ajo prezantonte faktet e dosjeve hetimore. Personalisht, megjithëse i dyzuar, jam përpjekur ta zbusë situatën, me dëshirën për t'i dhënë Dianës beneficin e dyshimit... ”.*

Marrdhëniet në shërbimin civil nuk janë marrdhënie besimi epror vartës, por janë marrëdhënie të parashikuara në ligjin 152/2013 ku citoj:

Administrimi i shërbimit civil udhëhiqet nga ligji dhe bazohet në parimin e shanseve të barabarta, mosdiskriminimit, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paañsisë politike, si dhe garanton qëndrueshmërinë në detyrë të nëpunësit civil dhe vazhdimësinë e shërbimit civil.

1. Nëpunësi civil kryen me profesionalizëm, paañsi, pa diskriminim dhe në përputhje me ligjin detyrat e tij në shërbimin civil.
 2. Nëpunësi civil detyrohet të respektojë Kushtetutën dhe të mbrojë të drejtat dhe liritë e njeriut, si dhe t'i shërbejë interesit publik.
- Në lidhje me shërbimet jashtë shtetit, faktet që është përpjekur të tregojë për udhëtimet jashtë shtetit për të provuar citoj:

dëshirën e mirë të drejtuesit të inistucionit..... dhepërsa kohë udhëtimet jashtë vendit janë ende forma të vlerësimit e stimulimit të punonjësve...;

Ose në vijim:

Sidoqoftë në 2 Qershor 2023, pra vetëm 24 ditë përpara prishjes së marrëdhënies, unë kam firmosur Urdhërin nr. 19 (nr. 312 protokollit të AK) kam vendosur që znj. D. (sërish me bashkëshoqëruesen/përkthyesen M.) të shkonte në shkollën verore në Rodos, Greqi në programin ekzekutiv CALEP. Nëse do të kishte ndonjë armiqësi mes nesh nuk bëhej fjalë që t'a dërgoja për një javë në "ishullin e Diellit", destinacioni më i vizituar në Greqi, në Korrik, me të gjitha shpenzimet e paguara.

Z.B. , flet në lidhje me udhëtimet jashtë shtetit sikur ato të jenë vizita turistike apo "qoka" personale të tij, dhe se është ai që vlerëson se mund tja bëj "qefin" dikujt ose jo.

Institucioni i AK ka një mision të qartë në zbatimin e ligjit 9121/2023 dhe për këtë duhet trajnim dhe forcim kapacitetesh në vazhdimësi pasi hetimet dhe metodat e hetimit janë shumë teknike dhe duhet trajnim i vazhdueshëm stafi për të realizuar zbatimin e ligjit, përafrimin e legjislationit, etj.

Sekretariati i AK ka vijuar me trajnimet e tij duke u mbështetur financiarisht me instrumente financiare të vazhdueshëm sic janë Taex, RCC, OECD, etj.

- në faqen 6 paragrafi fundit: nga data 6 deri në 10 mars 2023, bashkë me një grup punonjësish të AK, unë dhe znj. D. u paraqitëm pranë përfaqësuesve të KE në kuadër të procesit bilateral screening. Pa asnjë dyshim që znj. D. si krahu im i djathtë do ishte aty krahu meje.

AK është lider i Kapitullit 8 në procesin e Integritimit Evropian dhe në këtë kuadër Grupi Ndërinstitucional i Punës, kryesohej nga unë si Drejtues i GNPIE dhe gjithë drejtorët teknike në varësinë time në atë kohë dhe nuk kishte asnjë mundësi të ishte dikush tjetër pasi ka një VKM të posaçme për përberjen e GNPIE për çdo kapitull.

Ai i jep te drejta vetes të vlerësoje gjithashtu edhe nivelin e artikullimit të gjuhës së huaj për mua (mbrojtur një gjuhë të BE me vlerësim maksimal), por edhe për ish-bashkëpunëtorët e mia, të cilat i quan "të preferuarat", bashkëshoqëruese/përkthyes, trajtim ky përsëri diskriminues.

Natyrisht, kam bindjen dhe eksperiencën që është më dinjitoze të referohesh në shërbimin e përkthimit zyrtar të Komisionit Evropian, sesa të përpiqesh të flasësh në nivelin me të ulët në anglisht dhe të cenosh rëndë nivelin profesional të prezantimit si në rastin e letërshkruesit.

- Edhe fotot e paraqitura nga z.B. janë të manipuluar dhe provokative me insinuata të rënda edhe të standarteve morale. Marrëdhënia ime si Sekretar i Përgjithshëm me z.B. ka qënë një marrëdhënie korrekte punë, konstruktive dhe respekti gjithmonë në raport me punën në

cilësinë e drejtuesit të Komisionit me drejtuesin e Sekretariatit.

- Në pjesën III.2, citoj: ... *Për rrethana personale, të panevojshme për t'i shpjeguar, këtu mora përsipër ti jap si mundësi dorëheqjen si formë e largimit të butë, integriteti profesional i znj. D. në sytë e mi pas kësaj ishte zero.*

Kurajo e madhe të lexosh të shkruar fjalën integritet nga z. B. , kur është personi i cili ka intimiduar një nga anëtarët e GJEDNJ, fakt i njohur publikisht.

- Në lidhje me thelbin e çështjes sipas z. B. , ankimi pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi , nuk ka si qëllim të analizojë thebin e këtij procedimi disiplinor dhe “shkeljet”, e sajuara prej tij. Por detyrohem të përgjigjem shkurtimisht me disa komente.

Si mund të bëhet përgjegjës Sekretari i Përgjithshëm për një relacion që paraqet para Komisionit, kur hartimi i materialit bëhet nga struktura/drejtoria përkatëse. Si mund të bëhet përgjegjës SP për vjeljen e gjobave kur ka një strukturë përkatëse që e ndjekë atë, Drejtoria Juridike dhe Integritet. Lidhja e kontratave me Shërbimin Përmbaramor për vjelje gjobe e ushtron dhe e ka ushtruar që prej dhjetorit 2021 e deri sot z. B. në vetë të parë.

Si në të ashtuquajturin procedim disiplinor në ngarkimin tim, ashtu edhe në këtë letër, nga z.B. janë mundur të “identifikohen” dy apo tre raste të shkeljeve të pretenduara nga ana e tij të SP. Por ajo që harron të thotë z.B. është se për këto raste ka vendime Komisioni të mbështetura pa vërejtje në relacionin e Sekretariatit, të cilat janë në fuqi.

Kam ushtruar detyrën e Sekretarit të Përgjithshëm për 18 vjet e 5 muaj në AK. A e dini se sa peshë specifike kanë këto raste në gjithë këtë periudhë kohe? Mbi 100 raste të trajtuara nga Sekretariati në drejtimin tim në çdo vit kalendarik, fakt i cili provohet lehtë nëpërmjet raporteve vjetore të veprimtarisë se AK të paraqitura dhe vlerësuara nga Kuvendi i Shqipërisë.

Nuk mund të lë pa përmendur pasazhin: ...*Afërmendsh rrethanat personale/familjare të saj si bashkëshorte e z. B. D. luajtën rolin e tyre në këtë pikë...*

Ndoshta kjo përfaqëson tentativën më të ulët të kësaj letre, provokative dhe gjithsesi goditje e ulët në çdo këndvështrim. Kjo është një deklaratë që cenon rëndë integritetin tim si nëpunës civil i administratës publike në nivelin më të lartë të saj, duke aluduar se vendin e punës e kam prej bashkëshortit dhe jo prej karrierës profesionale, deklaratë seksiste që cenon integritetin tim si femër, nënë dhe bashkëshorte, që synon të intimidojë edhe bashkëshortin tim, person i njohur për shkak të funksioneve publike. *Aliena vivere quadra* ndoshta është moto e këtij personi. Në dijeninë time, nuk kemi patur dhe as kemi njohje apo rrethana personale të miat apo të familjareve të mi me z.B. .

Së fundi, lidhur me ligjëratën juridike që z. B. i bën konceptit të barrës së provës në rastet e diskriminimit, në praktikën e GjEDNj, ekziston edhe koncepti i zhvendosjes së barrës së provës, mjafton që të ekzistojë dyshimi se diskriminimi mund të ketë ndodhur.

Nëpërmjet kësaj letre dhe për arsyet më sipër, z. B. pothuajse e ktheu “dyshimin” ose “supozimin” në bindje mbi faktin e diskriminimit tim.

Deri më tani, veprimet jo të ligjshme të z. B. në cilësinë e titullarit të institucionit apo Komisioni Disiplinor i krijuar në mënyrë të paligjshme prej tij, kanë prodhuar deri tani 3 Vendime të Komisionerit të Mbikqyrjes së Shërbimit Civil dhe një Vendim të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të gjitha në disfavor të tij, duke u bërë shkak për cenimin e rëndë edhe të veprimtarisë dhe integritetit të institucionit, gjë për të cilën në vite jam investuar aq shumë.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Në bazë të nenit 3, pika 1 të LMD, diskriminimi përkufizohet si: çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga LMD, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3, pika 2, të LMD, si një situatë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji.

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, të cilat japin përkufizimin e diskriminimit, për të arritur në përfundimin se diskriminimi ka ndodhur, duhet të plotësohen njëkohësisht 3 elementë:

- ankuesja është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme. Ky trajtim mund të realizohet me veprime ose mosveprime, duke dalluar, përjashtuar apo kufizuar ankuesen në të drejtën për punësim;
- në krahasim me sesi janë trajtuar, trajtohen ose do të trajtoheshin të tjerët në një situatë të ngjashme, dhe;
- arsyeja për këtë trajtim është një/disa nga shkaqet që gëzojnë mbrojtje ligjore nga diskriminimi.

Si rregull, me qëllimin për të përcaktuar nëse pala ankuese është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë apo të pafavorshme krahasuar me punonjës të tjerë të Autoritetit të Konkurrencës, në

një situatë të njëjtë apo të ngjashme me të, nevojitet krahasuesi. Në rastet dhe kushtet kur ky “krahasues” mungon, vlerësohet nëse ankuesja është trajtuar në mënyrë të padrejtë e të pafavorshme, në raport me parashikimet ligjore që normojnë marrëdhënien e saj të punësimit. Pra, për të vërtetuar sjelljen diskriminuese, nuk është e nevojshme në çdo rast identifikimi i një krahasuesi konkret, por kërkesa për të provuar se pala ankuese i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të disfavorshëm, konsiderohet e përmbushur edhe nga një krahasues “hipotetik”, që në rastin konkret është mënyra se si subjekti kundër të cilit është paraqitur ankesa, z.D.B , në cilësinë e kryetarit të Komisionit të Konkurencës, ka respektuar standartet dhe kërkesat ligjore të parashikuara nga legjislacioni në fuqi që rregullon marrëdhënien e punës së ankuses në pozicionin “Sekretare e Përgjithshme” në institucionin e Autoritetit të Konkurencës. Për më tepër, në situatën faktike të çështjes objekt shqyrtimi, identifikimi i një krahasuesi në rrethana të ngjashme me ankuesen, bëhet i pamundur, pasi pozicioni i punës i mbajtur nga ankuesja, është i vetmi në këtë nivel dhe natyrë, në institucionin e Autoritetit të Konkurencës.

Në Komentin e Përgjithshëm nr.20, “Për mosdiskriminimin në të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore”, pika 10, të miratuar nga Komiteti për të Drejtat Sociale, Ekonomike dhe Kulturore, pranë Organizatës së Kombeve të Bashkuara, në vitin 2009, parashikohet se: “...Diskriminimi i drejtëpërdrejtë përfshin gjithashtu veprime ose mosveprime të dëmshme mbi bazën e një shkakut të mbrojtur, kur nuk ka një situatë të ngjashme të krahasueshme”.

A. Lidhur me trajtimin e pabarabartë dhe më pak të favorshëm të cilit i është nënshtruar ankuesja.

Për të vlerësuar pretendimin për diskriminim për shkaqet e pretenduara të parashtruar nga ankuesja, në radhë të parë, Komisioneri do të vlerësojë nëse ajo i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm, në të drejtën për punësim në lidhje me pretendimet e ngritura në ankesë.

Bazuar në informacionin dhe aktet e administruara gjatë procedurës së shqyrtimit të ankesës, rezultoi se:

Ankuesja D.D, e datëlindjes 27.08.1969, ka qenë në marrëdhënie pune në shërbimin civil pranë institucionit të Autoritetit të Konkurencës (AK), në pozicionin “Sekretare e Përgjithshme”.

Me shkresën nr.359 prot., datë 27.06.2023 “Njoftim për fillimin e procedimit disiplinor”, Kryetari i Autoritetit të Konkurencës, z. D.B , në cilësinë e eprorit direkt, i ka kërkuar Komisionit të Disiplinës, të fillojë ecurinë disiplinore për znj.D.D, me detyrë Sekretare e Përgjithshme.

Me urdhrin nr.20, datë 27.06.2023 “Për ngritjen e Komisionit Disiplinor”, të Kryetarit të Autoritetit të Konkurencës, z.D.B , është urdhëruar ngritja e Komisionit Disiplinor, për ndjekjen

e procedurës së ecurisë disiplinore të propozuar nga eprori direkt me shkresën nr.359, datë 27.06.2023, për znj.D.D, me detyrë Sekretare e Përgjithshme. Komisioni i Disiplinës ka këtë përbërje: 1. D.B , Kryetar; 2. M.K, Anëtar; 3. A.B, Anëtar; 4. A.P, Anëtar; 5. R.Ç, Anëtar. Me urdhrin nr.21, datë 27.06.2023 (Nr.359/2 prot) të Kryetarit të Autoritetit të Konkurrencës, z.D.B , është ngritur Sekretariati Teknik i Komisionit Disiplinor.

Rezulton se, me urdhër të Kryetarit të Autoritetit të Konkurrencës janë realizuar ndryshime në përbërjen e Komisionit të Disiplinës. Konkretisht, me urdhrin nr.23 (nr.359/11 prot), datë 11.07.2023 *“Për një ndryshim në urdhrin nr.359/1 prot, datë 27.06.2023 “Për ngritjen e Komisionit Disiplinor”*”, është ndryshuar anëtarja znj.A.B me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Mbikqyrjes së Tregjeve të Shërbimit/jo prodhuese, zëvendësohet me anëtarin z. Th.K, Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Buxhetit dhe Komunikimit; me urdhrin nr.26, datë 18.07.2023 (nr.359/21 prot) *“Për një ndryshim në urdhrin nr.359/1 prot datë 27.06.2023 “Për ngritjen e Komisionit Disiplinor”*”, janë ndryshuar anëtarët znj. A.P, Specialist i Sektorit të Komunikimit në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Buxhetit dhe Komunikimit me anëtaren znj.G.H, Inspektor në Drejtorinë e Analizës, Metodologjisë së Tregjeve dhe anëtarja znj.R.Ç, Përgjegjëse i Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Buxhetit në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Buxhetit dhe Komunikimit zëvendësohet me anëtaren znj.M.Y, Inspektor në Drejtorinë e Mbikqyrjes të Tregjeve Prodhuese; me urdhrin nr.30, datë 26.07.2023 (nr.359/27 prot) *“Për një ndryshim në urdhrin nr.359/21 prot, datë 18.07.2023 “Për ngritjen e Komisionit Disiplinor”*”, është bërë largimi i anëtares znj. G.H, Inspektor në Drejtorinë e Analizës, Metodologjisë së Tregjeve dhe zëvendësimi i saj me anëtaren znj.A.K, Inspektor (KryeEkonomist) në Drejtorinë e Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve.

Komisioni i Disiplinës, i ngritur me urdhrin e sipërcituar, pasi ka marrë në shqyrtim kërkesën e eprorit direkt të ankueses, në mbledhjen e datës 27.06.2023, ka vendosur pezullimin e ankueses deri në marrjen e vendimit përfundimtar, si dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj saj, me motivacionin për shkelje shumë të rëndë të parashikuar në gërmën “a”, pika 2, të nenit 57, të ligjit nr.152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar.

Referuar *“Raportit për Paaftësi në Punë për Sëmundje të Përgjithshme që Paguhet nga Punëdhënësi”*, me numër regjistri 2168, lëshuar në datën 27.06.2023, nga Qendra Shëndetësore Nr.1, Tiranë, rezulton se ankuesja ka qenë e paaftë për punë në datat 26-27.06.2023.

Komisioni Disiplinor, me shkresën nr.359/3 prot datë 29.06.2023 *“Njoftim për fillimin e procedimit Disiplinor”*, ka njoftuar ankuesen për pezullimin nga detyra dhe për nisjen e ecurisë disiplinore, duke i parashtruar shkeljet disiplinore të pretenduara në ngarkim të saj, si dhe e ka bërë me dije se shqyrtimi i shkeljeve të pretenduara në ngarkim të saj do të bëhet në datën 07.07.2023 ora 11:00. Rezulton se në datën 29.06.2023, ankuesja ka qenë në kushtet e paaftësisë për punë, fakt ky që rezulton i provuar sipas *Raportit për Paaftësi në Punë për Sëmundje të Përgjithshme që Paguhet nga Punëdhënësi*, me numër regjistri 2183, lëshuar në datën

29.06.2023, nga Qendra Shëndetësore Nr.1, Tiranë. Referuar procesverbalit nr.359/5 prot, datë 03.07.2023, rezulton se ankuesja ka marrë dijëni për fillimin e ecurisë disiplinore dhe dokumentacionin shoqërues, në datën 03.07.2023. Në datën 03.07.2023, ankuesja ka paraqitur një kërkesë për plotësim dokumentacioni në lidhje me procesin e ecurisë disiplinore të filluar nga saj. (nr.359/6 prot).

Në datën 03.07.2023, ankuesja ka paraqitur ankesë pranë Komisionerit të Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil (KMSHC), duke pretenduar se urdhri për ngritjen e Komisionit Disiplinor, i nxjerrë nga Kryetari i Komisionit të Konkurrencës dhe njoftimi për fillimin e procedimit disiplinor ndaj saj, i nxjerrë nga Komisioni i Disiplinës, ishin në kundërshtim me ligjin.

Me urdhrin Nr.54, datë 04.07.2023, KMSHC, ka urdhëruar nisjen e verifikimit të ligjshmërisë së aktit administrativ nr.359/1 prot., datë 27.06.2023 “*Urdhër për ngritjen e Komisionit Disiplinor*”, të nxjerrë nga institucioni i Autoritetit të Konkurrencës si dhe aktit nr.359/3 prot datë 29.06.2023 “*Njoftim për fillimin e procedimit disiplinor*”, të nxjerrë nga Komisioni i Disiplinës pranë Autoritetit të Konkurrencës. Nëpërmjet këtij urdhri është kërkuar që Komisioni i Disiplinës të pezullojë procedimin disiplinor ndaj ankuseses, deri në marrjen e vendimit përfundimtar për vlerësimin e ligjshmërisë, nga ana e KMSHC. Ky urdhër i është komunikuar Autoritetit të Konkurrencës, me shkresën nr.662/2 prot., datë 04.07.2023.

Në datën 07.07.2023, është mbledhur Komisioni i Disiplinës dhe ka vlerësuar se urdhri i KMSHC për pezullimin e procedurës disiplinore, nuk ka bazë ligjore dhe si i tillë nuk merret në konsideratë, ndërsa në lidhje me kërkesës e znj.D. për plotësimin e dokumentacionit, ka vendosur që t’i vihen në dispozicion aktet e kërkuara, përveç regjistrimeve audio, pasi ato janë zbardhur dhe do ti vihen në dispozicion në formën e procesverbaleve. Me shkresën nr.359/12 prot., datë 12.07.2023, ankuseses i janë vendosur në dispozicion aktet e kërkuara.

Rezulton se, në datën 07.07.2023, ankuesja ka qenë në kushtet e paaftësisë për punë, fakt ky që rezulton i provuar sipas *Raportit për Paaftësi në Punë për Sëmundje të Përgjithshme që Paguhen nga Punëdhënësi*, me numër regjistri 2275, lëshuar në datën 07.07.2023, nga Qendra Shëndetësore Nr.1, Tiranë.

Referuar procesverbalit të datës 14.07.2023, rezulton se, Komisioni i Disiplinës ka realizuar një mbledhje në këtë datë. Nga përmbajtja e procesverbalit, pasqyrohet se, pasi konfirmohet se ankuesja ka marrë në dorëzim aktet e kërkuara prej saj në datën 12.07.2023, caktohet se pretendimet e znj. D. do të dëgjohen në datën 27.07.2023, ora 11:00. Mbledhja e Komisionit të Disiplinës rezulton të jetë zhvilluar në mungesë të njërit prej anëtarëve të tij znj. A.P, e cila pasqyrohet në procesverbal se është në mungesë.

Rezulton se, në datën 14.07.2023, ankuesja ka qenë në kushtet e paaftësisë për punë, fakt ky që rezulton i provuar sipas *Raportit për Paaftësi në Punë për Sëmundje të Përgjithshme që Paguhen*

nga Punëdhënësi, me numër regjistri 2360, lëshuar në datën 14.07.2023, nga Qendra Shëndetësore Nr.1, Tiranë.

Me vendimin Nr.67, datë 14.07.2023 “Mbi përfundimin e procesit të inspektimit për vlerësimin e ligjshmërisë së akteve administrative, të nxjerra nga organet e disiplinës gjatë zhvillimit të procedurës së ecurisë disiplinore, të nisur në ngarkim të Sekretarit të Përgjithshëm, në institucionin e Autoritetit të Konkurencës”, KMSHC, ka vendosur: “Të paralajmërojë institucionin e Autoritetit të Konkurencës, për rregullimin e situatës së ligjshmërisë, në zbatim të kërkesave të neneve 57 deri 60, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.115, datë 05.03.2015, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil”; të ligjit nr.9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurencës”; e të neneve 109 dhe 113, të ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, duke vepruar në këtë mënyrë: 1. Kryetari i institucionit të Autoritetit të Konkurencës, të anulojë urdhrin nr.20, (nr.359/1 prot.), datë 27.06.2023, “Për ngritjen e Komisionit të Disiplinës”, i ndryshuar me urdhrin nr.23, (nr.359/11 prot.), datë 11.07.2023, për shkak të paligjshmërisë së konstatuar në përbërje të Komisionit të Disiplinës, duke rregulluar njëkohësisht pasojat e ardhura nga ky akt. 2. Komisioni i Disiplinës, të anulojë aktin nr.359/3 prot., datë 29.06.2023, “Njoftim për fillimin e procedimit disiplinor”, ku përfshihet edhe vendimi i pezullimit nga detyra për nëpunësen D.D, si dhe çdo akt tjetër të nxjerrë nga ky organ. 3. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat 5 ditë, nga marrja dijani për këtë vendim. 4. Me kalimin e këtij afati, të njoftohet me shkrim Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi, duke dërguar aktet përkatëse që materializojnë ekzekutimin e vendimit.....”. Rezulton se, Autoriteti i Konkurencës e ka kundërshtuar vendimin nr.67, datë 14.07.2023, të KMSHC, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke kërkuar edhe sigurimin e padisë nëpërmjet pezullimit të vendimit nr.67, datë 14.07.2023. Me vendimin nr. 4547 regj them., datë 26.07.2023, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, ka vendosur: “1. Refuzimin e kërkesës për marrjen e masës së sigurimit të padisë të Autoritetit të Konkurencës”.

Me shkresën nr.359/7 prot datë 17.07.2023, “Për pezullimin për shkak të ligjit”, ankuesja i është drejtuar Njësisë Përgjegjëse dhe për dijani Komisionit të Konkurencës, duke kërkuar nga Njësia Përgjegjëse në Autoritetin e Konkurencës, konstatimin e pezullimit për shkak të ligjit, në zbatim të nenit 54, pika 3/a, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Rezulton se, me urdhrin nr.75, datë 14.07.2023 (nr.2288 prot datë 14.07.2023), të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, znj.D.D, është emëruar në detyrën e Këshilltarit në Kabinetin e Inspektorit të Lartë Drejtësisë. Sipas këtij urdhri, marrëdhëniet financiare për ankuesen në këtë detyrë fillojnë më datë 17.07.2023.

Me shkresën nr.359/18 prot, datë 17.07.2023, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore, Buxhetit dhe Komunikimit, pranë Autoritetit të Konkurencës, ankueses i është kërkuar që ta paraqesë kërkesën nga e para në formatin e duhur, si dhe të përcaktojë afatin për të cilin po kërkonte pezullimin.

Ankuesja ka paraqitur një kërkesë tjetër me nr.359/19 prot., datë 17.07.2023, duke sqaruar se afati kërkohet në rastet e parashikuara nga neni 55, i ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar “Pezullimi me kërkesë të nëpunësit”, duke rikërkuar edhe një herë që në zbatim të nenit 54, pika 3/a të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Njësia Përgjegjëse pranë Autoritetit të Konkurrencës, të zbatojë detyrimin që ka sipas ligjit, konstatimin e pezullimit për shkak të ligjit. Ankuesja ka theksuar se, në zbatim të nenit 53, pika 1/a dhe nenit 54, pika 1/a, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, është emëruar në një pozicion pune jashtë shërbimit civil.

Me shkresën nr.359/22 prot., datë 18.07.2023, Njësia Përgjegjëse pranë Autoritetit të Konkurrencës, i ka kthyer përgjigje ankuses në lidhje me kërkesën për pezullim nga shërbimi civil, duke u shprehur se: “Në vijim tuajës nr.359/19 prot., datë 17.07.2023, referuar faktit se: a) nga ana juaj është kërkuar, citoj “ndërprerjen e marrëdhënies së punës në shërbimin civil me Autoritetin e Konkurrencës për shkak të emërimit dhe fillimit të marrëdhënieve të punës në një pozicion pune jashtë shërbimit civil”; b) pezullimi është kërkuar nga ana juaj, pasi ju vetë pa njoftim paraprak keni kaluar në një detyrë tjetër; si dhe c) nga ana e Autoritetit të Konkurrencës është faktuar emërimi juaj në një pozicion jashtë shërbimit civil, Konfirmojmë pezullimin nga shërbimi civil, bazuar në nenin 55/2 të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, për një periudhë deri në dy vjet.”

Rezulton se, ankuesja pasi ka marrë dijeni për shkresën nr.359/22 prot., datë 18.07.2023, të nxjerrë nga Njësia Përgjegjëse pranë Autoritetit të Konkurrencës, ka bërë ankesë pranë KMSHC. Me urdhrin nr.60, datë 20.07.2023, të KMSHC “Për verifikimin e ligjshmërisë së aktit administrativ nr.359/22 prot., datë 18.07.2023, me objekt pezullimin e marrëdhënies në shërbimin civil, të nxjerrë nga njësia përgjegjëse, në institucionin e Autoritetit të Konkurrencës”. Ky urdhër i është komunikuar Autoritetit të Konkurrencës me shkresën nr. 803/2 prot., datë 20.07.2023.

Me vendimin nr.1003, datë 18.07.20023, Komisioni i Konkurrencës, në institucionin e Autoritetit të Konkurrencës, bazuar në kërkesën për pezullim nr.359/17 prot., datë 17.07.2023, të paraqitur nga ankuesja, për të cilën, me shkresën nr. nr.359/22 prot., datë 18.07.2023, ka disponuar Njësia Përgjegjëse pranë Autoritetit të Konkurrencës, si më sipër pasqyruar, ka vendosur: “I. Largimin nga funksioni i Sekretares së Përgjithshme të Autoritetit të Konkurrencës së znj.D.D dhe përfundimin e marrëdhënies së saj të punës me Autoritetin e Konkurrencës. II. Përfundimin e marrëdhënies financiare nga data 17.07.2023.....”

Rezulton se në datën 18.07.2023, midis znj.D.D, z.Th.K dhe znj.Dh.S, është mbajtur procesverbali me nr.359/20 prot., datë 18.07.2023, në të cilin relatohet se procesverbali mbahet me qëllim dorëzimin e detyrës dhe inventarit fizik të gjendjes materiale, nga ana e ankuses.

Me vendimin nr.71, datë 25.07.2023, “Mbi përfundimin e procesit të inspektimit për vlerësimin e ligjshmërisë së akteve administrative që pasqyrojnë ndryshime në ecurinë e marrëdhënies në shërbimin civil, për pozicionin e punës “Sekretar i Përgjithshëm”, të nxjerra nga njësia përgjegjëse dhe Komisioni i Konkurencës, në institucionin Autoriteti i Konkurencës dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar ligjshmërinë, brenda afatit të caktuar”, KMSHC, ka vendosur: “Të paralajmërojë institucionin e Autoritetit të Konkurencës, për rregullimin e situatës së ligjshmërisë, në zbatim të kërkesave të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke vepruar në këtë mënyrë: 1. Drejtori i Burimeve Njerëzore, Buxhetit dhe Komunikimit, të anulohet shkresën nr.359/22 prot., datë 18.07.2023, si një akt i paligjshëm, i nxjerrë në kundërshtim me kërkesat e nenit 54, pika 1, germa a), të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe me përcaktimet e germës d), të nenit 109, të ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”. Pas këtij veprimi, me qëllim rregullimin e pasojave, njësia përgjegjëse, në zbatim të pikës 3, të nenit 54, ligjit nr.152/2013, të konstatojë pezullimin nga shërbimi civil për shkak të ligjit, për periudhën përkatëse të emërimit, për punonjësen D.D. 2. Pas konstatimit të pezullimit të marrëdhënies në shërbimin civil, njësia përgjegjëse, në zbatim të nenit 66, germa e/2, të ligjit nr.152/2013, i ndryshuar, të deklarojë me vendim lirimi nga shërbimi civil për nëpunësen D.D, për shkak të ligjit. 3. Komisioni i Konkurencës të konstatojë pavlefshmërinë absolute, sa i takon pikës 1 dhe 3, të vendimit nr. 1003, (nr.359/23 prot.), datë 18.07.2023, pasi ato kanë dalë në tejkalim të kompetencave të këtij organi, në zbatim të germës i), të nenit 108, dhe neneve 110 dhe 111, të ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.....”

Komisioni i Disiplinës rezulton të jetë mbledhur në datën 28.07.2023, një ditë pas datës së përcaktuar në mbledhjen e datës 14.07.2023 (data e caktuar ishte 27.07.2023). Referuar procesverbalit të mbajtur gjatë këtij takimi me nr.259/28 prot datë 28.07.2023, rezulton se, mbledhja është mbajtur me qëllim që të njihen anëtarët e rinj të Komisionit të Disiplinës me shkeljet në ngarkim të znj.D. dhe për të dëgjuar prapësimet e saj. Komisioni i Disiplinës ka vendosur ta ftojë edhe njëherë znj.D. , duke përcaktuar se mbledhja e radhës do të zhvillohej në datën 08.09.2023.

Rezulton se, në datën 01.08.2023, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, është regjistruar kërkesë padia e paraqitur nga ankuesja D.D, kundër Autoritetit të Konkurencës, me objekt: “1. Ndryshimin pjesërisht të aktit administrativ individual, për pikën 1 të Vendimit nr.1003 dt. 18.07.2023 të Komisionit të Konkurencës pranë Autoritetit të Konkurencës, si një akt administrativ i paligjshëm në kuptim të nenit 109, paragrafi a) c) dhe d) të Ligjit me nr.44/2015 “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me të cilin është vendosur “Largimi nga funksioni i Sekretares së Përgjithshme të Autoritetit të Konkurencës së znj.D.D dhe përfundimin e marrëdhënies së saj të punës me Autoritetin e Konkurencës”. 2. Detyrimin e Njesisë Përgjegjëse pranë Autoritetit të Konkurencës, Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Buxhetit dhe Komunikimit, të anulohet shkresën me lëndë “Kthim përgjigje” me nr.Prot.359/22 datës 17.07.2023 të lidhur me pezullimin nga shërbimi civil të nëpunëses D.D për një periudhë

2-vjet, si një akt administrativ i paligjshëm i nxjerrë në kundërshtim me kërkesat e nenit 54/a gërma a) të Ligjit me nr.152/2013 ‘Për nëpunësin civil’. 3. Detyrimin e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Buxhetit dhe Komunikimit pranë palës së paditur, Autoritetit të Konkurrencës, që të konstatojë pezullimin nga shërbimi civil për shkak të ligjit sipas Nenit 54 pika 1 a) të Ligjit me nr.152/2013 ‘Për nëpunësin civil’, për periudhën përkatëse të emërimit, për nëpunësen D.D, dhe përfundimin e marrëdhënies së punës si Sekretar i Përgjithshëm pranë Autoritetit të Konkurrencës për nëpunësen D.D. 4. Detyrimin e palës së paditur të plotësojë Librezën e Punës së nëpunësit civil D.D, për efekt të nenit 56 pika 3 e Ligjit me nr.153/2013, duke u shprehur për pezullimin pa afat nga shërbimi civil për shkak të ligjit dhe përfundimin e marrëdhënies së punës së nëpunëses D.D, si Sekretar i Përgjithshëm pranë Autoritetit të Konkurrencës.....”

Me datë 11.08.2023 (Nr.359/30 prot.), ankuesja i është drejtuar Autoritetit të Konkurrencës me një kërkesë, nëpërmjet të cilës kërkon sqarime në lidhje me pagën e muajit korrik 2023, pasi ka konstatuar se, në llogarinë e saj bankare është arkëtuar rreth 50% e pagës takuese që i korrespondon periudhës deri më 17 korrik, datë kur i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës me këtë institucion. Në lidhje me këtë kërkesë, ankueses i është kthyer përgjigje me shkresën nr.359/32 prot., datë 25.08.2023 “*Kthim përgjigje*”, të nënshkruar nga Kryetari i Autoritetit të Konkurrencës z. D.B , ku sqarohet në lidhje me pagën e muajit korrik 2023, si dhe bëhet me dije se, dorëzimi i detyrës nga ana e saj nuk ishte bërë i plotë. Në këtë shkresë parashtrohet se, nga verifikimet që ishin kryer nga ana e institucionit, pasi ankuesja kishte marrë librezën, kishte rezultuar se, ajo nuk kishte nënshkruar: “a) disa dokumente për procese pune për të cilat mbani përgjegjësi ligjore dhe që i përkasin periudhës kur keni ushtruar detyrën e Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe; b) vlerësimet e punës të punonjësve të Autoritetit të Konkurrencës, për periudhën korrik-dhjetor 2022 dhe janar-qershor 2023.” Nëpërmjet kësaj shkrese ankueses i është kërkuar të paraqitet pranë Autoritetit të Konkurrencës për të përfunduar rishikimin dhe nënshkrimin e dokumenteve brenda datës 31 gusht 2023.

Në vijim të komunikimeve në lidhje me çështjet e cituara në korrespondencën e mësipërme, ankuesja ka depozituar shkresën nr. 359/33 prot., datë 29.08.2023 me lëndë “*Për disa sqarime dhe komunikime në lidhje me shkresën e Autoritetit të Konkurrencës (AK) nr.359/32 prot., datë 25.08.2023*”. Në këtë shkresë, ankuesja pretendon se arsyet e dhëna në lidhje me pagën e muajit korrik 2023, ishin të pabazuara në ligj, se ajo kishte bërë dorëzimin e rregullt të detyrës dhe për këtë qëllim ishte mbajtur procesverbali i datës 18.07.2023, dhe se shprehte disponueshmërinë për datat 31 gusht dhe 1 shtator në orën 12, për sa ishte kërkuar në shkresën nr.359/32 prot., datë 25.08.2023 të Autoritetit të Konkurrencës. Në lidhje me vlerësimet e punës, ankuesja deklaroi se është penguar në ushtrimin e detyrës personalisht nga ana e Kryetarit të Komisionit të Konkurrencës duke kaluar edhe në intimidim që ka çuar sipas saj deri në cenim të integritetit të saj profesional por edhe fizik, referuar kjo një ngjarje që pretendohet të ketë ndodhur në datë 03.07.2023, në zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm. Ajo kërkon në këtë shkresë që të garantohet integriteti dhe ligjshmëria e procesit nga çdo intimidim i mundshëm nga Kryetari i AK apo çdo person tjetër që mund të jetë pjesë e këtij procesi. Në lidhje me librezën e punës, ankuesja

pretendon në këtë shkresë se, nga ana e institucionit nuk ishte kryer asnjë veprim për shkak se, me urdhër verbal të Kryetarit të Autoritetit të Konkurrencës është penguar kryerja e veprimeve për plotësimin e saj nga personi përgjegjës dhe vendosja e vulës së institucionit.

Me shkresën nr.359/40 prot datë 11.09.2023, me lëndë “*Në vijim të shkresës tuaj nr.359/32 prot., datë 25.08.2023*”, ankuesja i është drejtuar Autoritetit të Konkurrencës. Në këtë shkresë ankuesja deklaroi se, është paraqitur në datën 31.08.2023 pranë Autoritetit të Konkurrencës, ku ka përmbushur disa detyrime ligjore të mbartura nga periudha e ushtrimit të funksionit të Sekretarit të Përgjithshëm. Ankuesja pretendon se, nuk i është bërë me dije asnjë akt tjetër përveç disa vlerësime pune që i përkasin një periudhe të kaluar, konkretisht janar-qershor 2023, për të cilat ajo pretendon se është penguar në plotësimin dhe nënshkrimin e tyre. Në vijim, ankuesja shprehet se mbetet në pritje të konfirmimit dhe krijimit të kushteve nga ana e institucionit për përmbushjen e kësaj detyre.

Në përgjigje të shkresës së mësipërme të ankueses, me shkresën nr.359/41 prot., datë 11.9.2023, Autoriteti i Konkurrencës, i ka komunikuar ankueses se mund të paraqitet në datën 12.09.2023 nga ora 09:00- 14.00. Në vijim, me shkresën nr.359/42 prot., datë 11.09.2023, Autoriteti i Konkurrencës, i ka komunikuar ankueses se, me prezencën e saj në datën 12.09.2023, pranë këtij institucioni duhet të përmbushte detyrimet në lidhje me nënshkrimin e disa procedurave prokurimi (të listuara në shkresë).

Në vijim të komunikimeve të mësipërme, ankuesja i është drejtuar Autoritetit të Konkurrencës me shkresën nr.359/43 prot., datë 15.09.2023, me lëndë “*Në vijim të shkresës tuaj nr.359/41 prot., nr. 359/42 datë 11.09.2023*”. Nëpërmjet kësaj shkrese, ankuesja parashtroi se, nuk i është mundësuar brenda afateve ligjore përfundimi i procesit të vlerësimit të punës së nëpunësve civilë për periudhën janar-qershor 2023, për shkak të veprimeve të paligjshme të institucionit. Ankuesja shprehet se, përveç procesit të vlerësimeve të punës, nuk mbart më asnjë detyrim në raport me institucionin.

Me shkresën nr.359/37 prot., datë 08.09.2023, me lëndë “*Informacion lidhur me materialet e pafirmosura nga znj.D.*”, z.D.B , Kryetar i Autoritetit të Konkurrencës, është informuar mbi dokumentacionin e lënë pa firmosur nga ana e ankueses, pas largimit të saj nga funksioni i Sekretares së Përgjithshme, i cili ka të bëjë me vlerësimet e punës për periudhën korrik-dhjetor 2022 dhe një procedure prokurimi.

Me urdhrin nr. 37, datë 15.09.2023 “*Për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vlerësimit të punës për nëpunësit civil të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese për periudhën 01.07.2022 – 31.12.2022*”, të nxjerrë nga Kryetari i Autoritetit të Konkurrencës, z.D.B , është urdhëruar: “*1. Konstatimi i pavlefshmërisë absolute të vlerësimeve të punës për periudhën 01.07.2022 – 31.12.2022.....*”

Me shkresën nr. 359/31 prot ., datë 21.08.2023 “Njoftim për vijimin e procedimit disiplinor”, të Kryetarit të Autoritetit të Konkurrencës, z.D.B , në cilësinë e Kryetarit të Komisionit Disiplinor, ankuesja është bërë me dije se, Komisioni i Disiplinës, me qëllim ndjekjen e procedurave të ecurisë disiplinore për znj. D.D, në vijim të mbledhjes së datës 28.07.2023, ka vendosur të njoftojë ankuesen se pretendimet/prapësimet e saj do të dëgjohen në mbledhjen e datës 08.09.2023, ora 10:00. Rezulton se ankuesja ka marrë dijëni për këtë njoftim dhe në vijim me shkresën e datës 07.09.2023, me objekt “*Kthim përgjigje shkresës nr.359/31, datë 21.08.2023, të Autoritetit të Konkurrencës*”, i është drejtuar institucionit dhe për dijëni njësisë përgjegjëse pranë këtij institucioni, duke kërkuar konstatimin e pavlefshmërisë absolute të veprimeve të kryera nga ky komision, si dhe anulimin e akteve të prodhuara gjatë këtij procedimi disiplinor.

Referuar procesverbalit me nr.359/38 prot., datë 08.09.2023, Komisioni i Disiplinës, është mbledhur në këtë datë, në mungesë të ankueses, dhe ka marrë në shqyrtim informacionin ku evidentohet moskryerja e detyrave nga ankuesja gjatë ushtrimit të detyrës së “Sekretarit të Përgjithshëm”, pranë Autoritetit të Konkurrencës. Referuar procesverbalit, rezulton se, Komisioni i Disiplinës, ka marrë në shqyrtim edhe informacionin me nr.359/37 prot., datë 08.09.2023, në lidhje me mosfimosjen e vlerësimeve të punës dhe procedurës së prokurimit. Në vijim, Komisioni i Disiplinës, është mbledhur në datën 28.09.2023, në mungesë të ankueses, fakt që rezultoi i provuar sipas procesverbalit me nr.359/46 prot., datë 28.09.2023. Referuar këtij procesverbali, Komisioni i Disiplinës, pasi ka analizuar provat materiale në lidhje me shkeljet e pretenduara në ngarkim të ankueses, ka vlerësuar se, në respekt të nenit 57, pika 2 dhe 3, të ligjit nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, ato përbëjnë shkelje të rënda dhe shumë të rënda, në respekt të nenit 58/ç, të këtij ligji vendosi “*Largimin nga shërbimi civil për znj.D.D*”.

Në vijim të mbledhjes së datës 28.09.2023, Komisioni i Disiplinës, me vendimin nr.1, datë 28.09.2023 (Nr.359/47 prot., datë 28.09.2023) ka vendosur : “*I. Dhënien e masës disiplinore “Largim nga shërbimi civil” për znj. D.D. II. Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijëni*”. Ky vendim i është komunikuar ankueses nëpërmjet shkresës nr.359/48 prot., datë 06.10.2023.

Në lidhje me sa më sipër, ankuesja i është drejtuar KMSHC, i cili me vendimin nr.91, datë 02.11.2023 “*Mbi përfundimin e procesit të vlerësimit të ligjshmërisë gjatë aplikimit të masës disiplinore, largim nga shërbimi civil, në ngarkim të ish “Sekretarit të Përgjithshëm” dhe paralajmërimin e institucionit Autoriteti i Konkurrencës për të rregulluar paligjshmërinë e konstatuar*”, ka vendosur: “*Të paralajmëroj institucionin e Autoritetit të Konkurrencës për rregullimin e situatës së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të kërkesave ligjore ashtu si është pasqyruar në përmbajtjen e këtij vendimi duke vepruar në këtë mënyrë: I. Komisioni i Disiplinës, të konstatojë pavlefshmërinë absolute të Vendimit nr.1, (nr.359/47 prot.), datë 28.09.2023, me të cilin ka vendosur dhënien e masës disiplinore “Largim nga shërbimi civil”, për nëpunësen D.D, si dhe çdo akt tjetër të nxjerrë nga ky organ disiplinor.....”.*

Në përfundim të shqyrtimit të fakteve e rrethanave të cilat rezultuan të provuara gjatë shqyrtimit të ankesës, si dhe pretendimeve të palës ankuese dhe prapësimeve të subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa, Komisioneri vlerëson si më poshtë:

- *Lidhur me procedurat gjyqësore të filluara nga palët.*

LMD, ka parashikuar në nenin 34, pika 1, të tij se, çdo person ose grup personash që pretendojnë se ndaj tyre është ushtruar diskriminim mund të paraqesin kërkesë padi përpara gjykatës kompetente, ndërsa bazuar në pikën 2, të po këtij neni, parashikohet se, paraqitja e ankimit përpara Komisionerit nuk është kusht për të paraqitur një kërkesë padi dhe nuk përbën pengesë për personin e dëmtuar t'i drejtohet gjykatës. Nga ana tjetër, bazuar në nenin 32/1/a të ligjit LMD, Komisioneri ka kompetencë që të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, siç parashikohet në këtë ligj.

Në nenin 33, pika 7/4, të LMD, parashikohet: *“Kur Komisioneri vihet në dijeni se ankuesi ka paraqitur kërkesë padi në gjykatë me objekt konstatim diskriminimi, ndërkohë që ka paraqitur të njëjtën ankesë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe çështja është në shqyrtim e sipër, Komisioneri merr vendim për pushimin e çështjes.”*

Nga aktet e administruara nuk rezulton që pranë Gjykatës të jenë duke u shqyrtuar të njëjtat pretendime për diskriminim, të cilat janë objekt i ankesës në shqyrtim. Proceset gjyqësore të cilat janë duke u shqyrtuar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, kanë objekt të ndryshëm nga objekti i ankesës objekt shqyrtimi. Pra, ankuesja ka zgjedhur që të mos kërkojë para gjykatës kërkimin për diskriminim, që ka paraqitur për trajtim para Komisionerit në këtë ankesë.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se çështjet që janë duke u shqyrtuar pranë gjykatës dhe çështja objekt shqyrtimi pranë Komisionerit nuk kanë mbivendosje, e për rrjedhojë nuk ekziston asnjë pengesë ligjore për të marrë në shqyrtim ankesën e paraqitur nga ankuesja.

- *Në lidhje me trajtimin e padrejtë dhe të disfavorshëm të ankueses, sa i përket momentit të fillimit të ecurisë disiplinore në ngarkim të saj, në pozicionin “Sekretare e Përgjithshme” në institucionin e Autoritetit të Konkurrencës.*

Marrëdhëniet e punës midis ankueses dhe Autoritetit të Konkurrencës janë rregulluar bazuar në ligjin e posaçëm Nr. 9121, datë 28.7.2003 *“Për Mbrojtjen e Konkurrencës”*, të ndryshuar (në vijim ligji nr.9121/2003) dhe ligjit Nr. 152/2013 *“Për Nëpunësin Civil”*, të ndryshuar (në vijim ligji nr.152/2013). Ankuesja D.D ka ushtruar detyrën si Sekretare e Përgjithshme dhe ka gëzuar statusin si nëpunësja më e lartë civile pranë institucionit të Autoritetit të Konkurrencës.

Për të vlerësuar pretendimet e ankueses se, me veprimet e tij subjekti kundër të cilit ka paraqitur ankesën e ka ekspozuar atë ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të disfavorshëm në kuadër të procedurës disiplinore të filluar në ngarkim të saj, Komisioneri do të vlerësojë veprimet dhe mosveprimet e subjektit në raport me parashikimet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë procedurën disiplinore të nëpunësit civil si dhe parashikimet që bëhen në ligjin e posaçëm, që rregullon marrëdhënien e punësimit dhe funksionin “Sekretar iPërgjithshëm” në Autoritetin e Konkurrencës, që ka mbajtur ankuesja.

Referuar nenit 18, të ligjit nr. 9121/2003, Autoriteti i Konkurrencës, është organ publik, i pavarur, i cili përbëhet nga Komisioni dhe nga Sekretariati. Sipas nenit 19, të po këtij ligji, përcaktohet se, Komisioni i Konkurrencës, vepron si një organ kolegjal i përhershëm, i përbërë nga pesë anëtarë dhe është organi vendimmarrës i Autoritetit të Konkurrencës.

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit të Konkurrencës, parashikohen në nenin 24, të ligjit nr. 9121/2003, ku përcaktohet :

“Komisioni ka këto detyra dhe përgjegjësi:

a) harton politikën kombëtare të konkurrencës;

b) (shfuqizuar);

c) miraton rregulloren e brendshme të funksionimit të Autoritetit;

ç) mbikëqyr punën e Sekretariatit për zbatimin e dispozitave të këtij ligji;

d) merr vendime sipas këtij ligji;

dh) nxjerr rregullore dhe udhëzime në zbatim të këtij ligji;

e) brenda 3-mujorit të parë të vitit pasardhës paraqet në Kuvend raportin vjetor të Autoritetit;

ë) me kërkesën e komisioneve të Kuvendit, jep vlerësime për çështje që lidhen me konkurrencën dhe legjislacionin në këtë fushë;

f) u jep vlerësime dhe rekomandime organeve të administratës qendrore e vendore dhe institucioneve të tjera publike, shoqatave tregtare, sindikatave, shoqatave të konsumatorit, dhomave të tregtisë dhe të industrisë, për çështjet që lidhen me konkurrencën;

g) përfaqëson Autoritetin, brenda dhe jashtë vendit, në marrëdhëniet me institucionet e tjera dhe ato simotra;

gj) përcakton përparësitë e hetimeve dhe afatet përkatëse për to”

Detyrat e Kryetarit të Komisionit të Konkurrencës, përcaktohen në nenin 25, të ligjit nr.9121/2003, ku parashikohet si vijon:

“1. Kryetari i Komisionit ka këto detyra:

a) përgatit, thërret dhe drejton mbledhjet e Komisionit;

b) bashkërendon punën ndërmjet anëtarëve të Komisionit;

c) nënshkruan aktet e Komisionit, me përjashtim të vendimeve, që nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e pranishëm në mbledhje.

ç) përfaqëson Autoritetin në marrëdhënie me të tretët;

Sekretariati drejtohet nga Sekretari i Përgjithshëm, i cili zgjidhet nga Komisioni. (neni 27, ligji nr. 9121/2003). Ankuesja në cilësinë e Sekretarit të Përgjithshëm, ka qenë drejtuese e Sekretariatit të Autoritetit të Konkurrencës. Përgjegjësitë e Sekretariatit të Autoritetit të Konkurrencës dhe të Sekretarit të Përgjithshëm, janë të përcaktuara në mënyrë të drejtëpërdrejtë në ligjin nr.9121/2003 dhe konkretisht në nenet 28 dhe 29, si më poshtë:

“Neni 28

Përgjegjësitë e Sekretariatit

Sekretariati, për ndjekjen e zbatimit të dispozitave të këtij ligji, ka këto përgjegjësi:

- a) monitoron dhe analizon kushtet e tregut për zhvillimin e konkurrencës së lirë dhe efektive;*
- b) kryen hetime, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative, këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi;*
- c) harton dhe paraqet raportet e hetimit pranë Komisionit për vendimmarrje;*
- ç) siguron publikimin e vendimeve të marra, të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të këtij ligji, si dhe të raportit vjetor të Autoritetit;*
- d) ndjek dhe kontrollon zbatimin e vendimeve të marra nga Komisioni.”*

Neni 29

Përgjegjësitë e Sekretarit të Përgjithshëm

1. Sekretari i Përgjithshëm përgjigjet për mbarëvajtjen e veprimtarisë së Sekretariatit. Në mungesë të tij ose në pamundësi për të vepruar, me miratim të Komisionit, ai mund t'ia delegojë përgjegjësitë njërit prej drejtorëve të drejtorive të Sekretariatit.

2. Sekretari i Përgjithshëm përgjigjet për:

- a) zbatimin e procedurave të këtij ligji për shqyrtimin e rasteve;*
- b) hartimin dhe paraqitjen e raportit përmbledhës të hetimit para Komisionit për vendimmarrje;*
- c) bashkërendimin e punës së drejtorive të Sekretariatit;*
- ç) përgatitjen e raportit vjetor të punës së Autoritetit;*
- d) bashkëpunimin me institucionet e tjera, brenda dhe jashtë vendit, për zgjidhjen e çështjeve;*
- dh) nënshkrimin e korrespondencës shkresore të Sekretariatit.”*

Referuar ligjit nr.152/2013, disiplina në shërbimin civil, rregullohet në kreun X, neni 57 deri në nenin 61, të këtij ligji.

Në nenin 57, të ligjit nr.152/2013, përcaktohet se: “1. Nëpunësi civil është përgjegjës për shkeljen me faj të detyrimeve të nëpunësit civil sipas ligjit. Shkeljet në shërbimin civil ndahen në:

- a) shkelje shumë të rënda;*
 - b) shkelje të rënda;*
 - c) shkelje të lehta.....”.*
- Më tej në pikën 2, 3 dhe 4, të këtij neni, parashikohet kategorizimi i secilës prej shkeljeve të sipërciatuara.

Në nenin 58, të ligjit nr. 152/2013, parashikohen llojet e masave disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, të cilat janë si më poshtë:

“Masat disiplinore që mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil janë:

- a) vërejtje;*
- b) mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj;*
- c) pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet.*
- ç) largim nga shërbimi civil.”*

Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore ndaj nëpunësit civil parashikohet në nenin 59, të ligjit nr.152/2013. Sipas pikës 1, të nenit të sipërcituar, masa disiplinore e parashikuar në shkronjën “a” të nenit 58, merret nga eprori direkt, i cili është i detyruar të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen me faj të detyrimeve nga nëpunësi civil, ndërsa masat disiplinore të parashikuara në shkronjat “b”, “c” dhe “ç” të nenit 58 të këtij ligji, janë në kompetencën e Komisionit Disiplinor.

Rezulton se, shkeljet e pretenduara në ngarkim të ankueses, janë kategorizuar në nivelin shumë të rëndë, për sa kohë që është ngritur Komisioni i Disiplinës, për t’i shqyrtuar ato.

Bazuar në aktet e administruara, rezulton se, akti i parë në lidhje me ecurinë disiplinore të filluar ndaj ankueses figuron shkresa Nr.359 prot datë 27.06.2023 me lëndë “*Njoftim për fillimin e procedimit disiplinor*”, që z. D.B , Kryetar i Komisionit të Konkurencës i drejton ankueses, znj.D.D, Sekretare e Përgjithshme, njëkohësisht për dijeni Komisionit të Konkurencës dhe Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Komunikimit pranë Autoritetit të Konkurencës. Në këtë shkresë, citohet si vijon: “ *Në mbledhjen e datës 27.06.2023, ora 11.00, Komisioni i Konkurencës shqyrtoi sipas rendit të ditës nr.15, datë 26.06.2023 “Për disa problematika të brendshme të Autoritetit të Konkurencës”. Në zbatim të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Komisioni i Konkurencës konstatoi se për znj. D.D, me detyrë Sekretare e Përgjithshme, duhet të fillojë procedimi disiplinor. Për sa më sipër, mbështetur në ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në cilësinë e eprorit direkt i kërkoj Komisionit Disiplinor të fillojë ecurinë disiplinore për znj.D.D, me detyrë Sekretare e Përgjithshme”.*

Referuar pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr.152/2013, parashikohet se:

“4. Komisioni disiplinor fillon procedimin:

- a) me kërkesë të eprorit direkt të nëpunësit civil;*
- b) me rekomandim të çdo organi tjetër publik ose njësie me kompetenca kontrolli administrativ, inspektimi financiar apo auditi, ose të çdo zyrtari tjetër me detyra kontrolli hierarkik mbi nëpunësin civil;*
- c) me nismën e çdo anëtari të komisionit, bazuar në fakte konkrete të provueshme për kryerjen e një shkeljeje disiplinore.”*

Bazuar në dispozitën e mësipërme, është Komisioni Disiplinor i cili vendos për të filluar ose jo procedimin disiplinor ndaj nëpunësit civil.

Në bazë të akteve të administruara, konstatohet se, jo vetëm pa patur akoma një vendim nga Komisioni i Disiplinë në institucionin e Autoritetit të Konkurrencës, por për më tepër ende pa u ngritur ky organ disiplinor pranë këtij institucioni, ankuesja është njoftuar për fillimin e procedimit disiplinor nga ana e z. D.B , Kryetar i Komisionit të Konkurrencës, nëpërmjet shkresës nr.359 prot datë 27.06.2023. Komisioneri vlerëson se, një veprim i tillë vjen në kundërshtim me parashikimet e nenit 59, pika 4, të ligjit nr.152/2013, pasi është kompetencë e Komisionit Disiplinor pranë Autoritetit të Kompetencës, për të filluar dhe për të njoftuar ankuesen për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të saj.

Rezulton se, Komisioni i Disiplinës, me shkresën nr.359/3 prot datë 29.06.2023, ka njoftuar ankuesen për fillimin e procedurës disiplinore në ngarkim të saj, bazuar në kërkesën e z. D.B , Kryetar i Autoritetit të Konkurrencës, në cilësinë e eprorit direkt të ankueses, njëkohësisht Kryetar i Komisionit të Disiplinës. Nëpërmjet shkresës nr.359/3 prot., datë 29.06.2023, ankuesja është njoftuar gjithashtu se, Komisioni i Disiplinës, në mbledhjen e datës 27.06.2023 ora 15.30 kishte vendosur në zbatim të nenit 59, pika 6, të ligjit nr.152/2013, pezullimin e saj nga shërbimi civil deri në marrjen e vendimit përfundimtar. Sikurse në shkresën me nr.359 prot datë 27.06.2023 *“Njoftim për fillimin e procedimit disiplinor”*, që z. D.B , Kryetar i Autoritetit të Konkurrencës, i ka komunikuar ankueses, ashtu edhe shkresa nr. 359/3 prot datë 29.06.2023 *“Njoftim për fillimin e procedimit disiplinor”*, e Komisionit të Disiplinës drejtuar ankueses, citon se: *“Në mbledhjen nr.15 të datës 27.06.2023, ora 11:00, Komisioni i Konkurrencës mori në shqyrtim pikën e rednit të ditës “Për disa problematika të brendshme të Autoritetit të Konkurrencës. Në zbatim të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, Komisioni i Konkurrencës konstatoi se ndaj Znj.D.D, me detyrë Sekretare e Përgjithshme, duhet të fillojë procedimi disiplinor.....”*

Ankuesja, e cila ka mbajtur detyrën “Sekretare e Përgjithshme” e institucionit të Autoritetit të Konkurrencës, në mbështetje të nenit 27 të ligjit nr. 9121/2003, është emëruar në këtë detyrë nga Komisioni i Konkurrencës, i cili sipas nenit 19, të po këtij ligji, vepron si një organ kolegjal i përhershëm, i përbërë nga pesë anëtarë. Nga ana tjetër, puna e ankueses, si Sekretare e Përgjithshme e Sekretariatit pranë Autoritetit të Konkurrencës, mbikëqyret nga Komisioni i Konkurrencës, si organ kolegjal, organ i cili në referim të nenit 24, germa “ç”, ka kompetencën të mbikëqyr punën e Sekretariatit, për zbatimin e dispozitave të këtij ligji.

Referuar nenit 25, të ligjit të posaçëm nr.9121/2003, Kryetari i Komisionit të Konkurrencës, detyrë e cila mbahet nga z. D.B , nuk ka kompetencë që të mbikëqyrë punën e Sekretariatit dhe rrjedhimisht të ankueses, në detyrën e Sekretares së Përgjithshme, si drejtuese e këtij Sekretariati, pasi mbikëqyrja e Sekretariatit është kompetencë dhe përgjegjësi e Komisionit të Konkurrencës, si organ kolegjal, i përbërë nga pesë anëtarë.

Gjatë shqyrtimit të ankesës nuk u administrua ndonjë akt ku të pasqyrohet dhe materializohet vendimarrja apo vullneti i organit kolegjal, Komisionit të Konkurrencës, i cili ka kompetencë që të mbikëqyrë punën e Sekretariatit dhe rrjedhimisht të ankueses në detyrën e Sekretares së Përgjithshme si drejtuese e Sekretariatit, se ndaj saj duhet të fillojë procedimi disiplinor. Procesverbali i mbledhjes nr.15 të datës 27.06.2023, nuk rezulton që t'i jetë vendosur në dispozicion as KMSHC, gjatë procedurave hetimore të zhvilluara nga ky institucion i pavarur në lidhje me verifikimin e ligjshmërisë së procedurës për fillimin e ecurisë disiplinore ndaj ankueses.

Në analizë të dispozitave ligjore të sipërcituara të ligjit nr.9121/2003, Komisioneri vlerëson se, eprori direkt për ankuesen në pozicionin Sekretare e Përgjithshme, në Autoritetin e Konkurrencës, është Komisioni i Konkurrencës, në cilësinë e organit kolegjal të përhershëm të përbërë prej 5 anëtarësh dhe jo Kryetari i Komisionit të Konkurrencës, z.D.B . Në këtë kuptim, edhe kërkesa e paraqitur nga z. D.B , Kryetar i Komisionit të Konkurrencës, për fillimin e ecurisë disiplinore në ngarkim të ankueses, është e pabazuar në nenin 59, pika 4, të ligjit nr.152/2013, pasi në analizë të dispozitave të ligjit të posaçëm nr.9121/2003, që rregullojnë përgjegjësitë dhe kompetencat e Komisionit të Konkurrencës, Kryetarit të Komisionit të Konkurrencës dhe Sekretarit të Përgjithshëm, pranë institucionit të Autoritetit të Konkurrencës, Kryetari i Komisionit të Konkurrencës, z. D.B , nuk gëzon cilësinë e eprorit direkt të ankueses D.D, në pozicionin “Sekretare e Përgjithshme”.

Referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.115, 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” (në vijim VKM Nr.115/2014), në Kreun I, pika 3, të këtij akti nënligjor bëhet rregullimi i mëposhtëm, në lidhje me përbërjen e Komisionit Disiplinor për institucionet e pavarura, sikurse në rastin konkret është institucioni i Autoritetit të Konkurrencës:

“3. Për institucionet e pavarura, bashkitë dhe qarqet, komisioni disiplinor përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë dhe ka përbërjen e mëposhtme:

a) nëpunësin më të lartë civil në atë institucion;

b) eprorin direkt të nëpunësit civil për të cilin ka nisur ecuria disiplinore;

c) drejtuesin e njësisë përgjegjëse për atë institucion;

ç) nëpunësin më të vjetër civil të institucionit ku punon nëpunësi për të cilin ka nisur ecuria disiplinore;

d) nëpunësin më të vjetër civil të njësisë ku punon nëpunësi për të cilin ka nisur ecuria disiplinore.”

Bazuar në konkluzionet e arritura më sipër në lidhje me faktin se, cilësinë e eprorit direkt të ankueses e gëzon Komisioni i Konkurrencës, si organi kolegjal i përhershëm i përbërë nga pesë anëtarë, nga aktet e administruara rezulton se, edhe pas ndryshimeve që janë bërë në lidhje me përbërjen e Komisionit të Disiplinës, konstatohet se, eprori direkt i ankueses për të cilën ka nisur ecuria disiplinore, Komisioni i Konkurrencës, si organ kolegjal i përhershëm i përbërë nga pesë

anëtarë, nuk rezulton i përfaqësuar në Komisionin e Disiplinës, i ngarkuar me procedurën disiplinore ndaj ankueses.

Sa më sipër rezulton se:

- Kërkesa për fillimin e ecurisë disiplinore në ngarkim të ankueses nuk është bërë nga eprori i saj direkt, që në rastin konkret këtë cilësi e gëzon Komisioni i Konkurrencës, si organ kolegjal të përhershëm, i përbërë nga pesë anëtarë dhe jo Kryetari i Komisionit të Konkurrencës. Rrjedhimisht, Komisioni i Disiplinës është vënë në lëvizje dhe ka filluar procedimin disiplinor në ngarkim të ankueses, nga ana e një subjekti që nuk legjitimohet në cilësinë e eprorit direkt, për të vënë në lëvizje organin e disiplinës në institucionin e Autoritetit të Konkurrencës.
- Komisioni Disiplinor, i ngritur me urdhrin nr.20, datë 27.06.2023, pavarësisht ndryshimeve të mëvonshme që janë bërë në lidhje me përbërjen e tij, nëpërmjet urdhrin nr.23, datë 11.07.2023, urdhrin nr.26, datë 18.07.2023 dhe urdhrin nr.30, datë 26.07.2023, konstatohet se është ngritur në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë përbërjen e këtij organi, të përcaktuara në VKM Nr.115/2004, si dhe në kundërshtim me ligjin organik që rregullon veprimtarinë e institucionit të Autoritetit të Konkurrencës.

Në këto kushte, konstatohet se procesi i fillimit të ecurisë disiplinore dhe përbërja e organit disiplinor nuk është bërë në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Për pasojë çdo akt, veprim apo vendimarrje e kryer gjatë kësaj procedure disiplinore, është marrë në kundërshtim me parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

- *Në lidhje me trajtimin e padrejtë dhe të disfavorshëm të ankueses, gjatë procedurës së ndjekur për pezullim nga shërbimi civil për shkak të ligjit dhe ndryshimin e ecurisë së marrëdhënies së punës në shërbimin civil.*

Procedurat e pezullimit nga shërbimi civil, janë të parashikuara në kreun IX, nenet 53 deri në nenin 56, të ligjit nr.152/2013. Në nenin 53 “*Pezullimi nga shërbimi civil*”, të ligjit nr.152/2013, parashikohen rastet e ndërprerjes së përkohshme të marrëdhënies në shërbimin civil. Sipas pikës 1, të kësaj dispozite, parashikohet:

“1. Pezullimi është ndërprerja e përkohshme e marrëdhënies në shërbimin civil, në këto raste:

a) për shkak të njërës prej arsyeve të pezullimit, sipas nenit 54 të këtij ligji;

b) me kërkesë të vetë nëpunësit;

c) në rastin e procedimit disiplinor sipas pikës 6 të nenit 59 të këtij ligji.

Në vijim, në pikën 2, të nenit 53, të ligjit nr.152/2013, theksohet se: “*2. Gjatë periudhës së pezullimit, marrëdhënia e shërbimit civil nuk mund të përfundojë dhe nuk mund të ndryshojë, përveçse me nismën e nëpunësit të pezulluar ose kur parashikohet shprehimisht nga ky ligj.*”

Sipas nenit 54 *“Pezullimi për shkak të ligjit”*, të ligjit nr.152/2013, rezulton se, një nga shkaqet e pezullimit për shkak të ligjit, është rasti kur, nëpunësi civil emërohet në një nga funksionet e parashikuara në shkronjat “b”, “c” dhe “gj”, të nenit 2, të këtij ligji, për periudhën përkatëse të emërimit.

Referuar nenit 2, të ligjit nr.152/2013, funksionet e parashikuara në shkronjat “b”, “c” dhe “gj, të kësaj dispozite janë: ministrit dhe zëvendësministrit (shkronja “b”), funksionarët e emëruar nga Kuvendi, Presidenti i Republikës ose Këshilli i Ministrave (shkronja “c”) dhe funksionarët e kabinetit (shkronja “gj”)

Referuar aktit të emërimit nr.75, datë 14.07.2023 *“Për emërim në detyrë”*, të Inspektoriatit të Lartë të Drejtësisë, ankuesja është emëruar në detyrën e “Këshilltarit”, në Kabinetin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, pozicion pune, i cili në bazë të pikës 7, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.893, datë 17.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të organizimit dhe funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm”*, klasifikohet tek funksionarët e kabinetit. Për rrjedhojë, pozicioni i punës “Këshilltar”, në Kabinetin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në të cilin është emëruar ankuesja, përfshihet në kategorinë e zyrtarëve të parashikuar në gemën “gj” të nenit 2, të ligjit nr.152/2013.

Sipas pikës 3, të nenit 54, të ligjit nr.152/2013, parashikohet se: *“3. Konstatimi i pezullimit bëhet me marrjen dijani për shkakun e pezullimit, nga: a) njësia e burimeve njerëzore të institucionit, ku nëpunësi civil është i emëruar;”*

Neni 55, i përdorur si referencë ligjore nga njësia përgjegjëse, rregullon situatën kur pezullimi nga shërbimi civil bëhet me kërkesë të nëpunësit. Në pikën 2, të kësaj dispozite parashikohet: *“2. Nëpunësi civil mund të pezullohet me kërkesë të motivuar të tij edhe për shkak të një interesi tjetër të ligjshëm të tij, sipas përcaktimeve të vendosura nga Këshilli i Ministrave, për një periudhë deri në 2 vjet”*

Sa më sipër, ankuesja ndodhet në kushtet e përcaktuara në pikën 1, germa “a”, të nenit 54 *“Pezullim për shkak të ligjit”*, të ligjit nr.152/2013, e për pasojë, në zbatim të pikës 3, të kësaj dispozite, njësia e burimeve njerëzore, pranë institucionit të Autoritetit të Konkurrencës, në rolin e njësisë përgjegjëse, me marrjen dijani për shkakun e pezullimit, duhet të konstatonte pezullimin nga shërbimi civil për shkak të ligjit, për gjithë periudhën e emërimit të ankueses në funksionin “Këshilltar”, në Kabinetin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për sa kohë që akti i emërimit të ankueses në këtë pozicion nuk përcakton ndonjë afat. Në zbatim të gabuar të ligjit, njësia përgjegjëse me shkresën nr.359/22, datë 18.07.2023, ka konfirmuar pezullimin nga shërbimi civil të ankueses, sipas nenit 52/2, të ligjit nr.152/2013.

Bazuar në parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioneri vlerëson se, pezullimi për shkak të ligjit, sipas nenit 54, të ligjit nr.152/2013, nuk është objekt vlerësimi dhe diskrecioni për njësinë përgjegjëse, por përbën një detyrim për këtë të fundit, që në momentin që vjen në dijeni të shkakut të pezullimit.

“Pezullimi” është ndërprerja e përkohshme e marrëdhënies në shërbimin civil.

Neni 63 “Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil”, parashikon:

“Marrëdhënia në shërbimin civil përfundon nëpërmjet:

a) lirimit nga shërbimi civil;

b) largimit nga shërbimi civil, si masë disiplinore;

c) pranisë së një shkakut të parashikuar nga neni 65 i këtij ligji”

Lirimi nga shërbimi civil, si një nga mënyrat e përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil, parashikohet në nenin 66, të ligjit nr.152/2013. Në këtë dispozitë, në pikën 1, shkronja “e”, nën-pika e/2, përcaktohet, se marrëdhënia në shërbimin civil përfundon nëpërmjet lirimit në rastin e parashikuar nga neni 56 “Efektet e Pezullimit”, të këtij ligji. Ndërsa në pikën 4, germa “a” të po kësaj dispozite, përcaktohet se: “4. Lirimi deklarohet me vendim të: a) njësisë së burimeve njerëzore të institucionit, ku nëpunësi ushtron detyrën;”

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, pas konstatimit të pezullimit për shkak të ligjit, njësia përgjegjëse/njësia e burimeve njerëzore, pranë Autoritetit të Konkurencës, duket të kishte vendosur edhe lirim nga shërbimi civil të ankueses nga pozicioni “Sekretare e Përgjithshme”, pranë Autoritetit të Konkurencës. Komisioneri, konstaton se, njësia e burimeve njerëzore, pranë Autoritetit të Konkurencës, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, nuk i ka ushtruar kompetencat e saj. Komisioneri vlerëson se, ushtrimi i kompetencave nuk është vetëm një e drejtë, por edhe një detyrim i autoriteteve publike. Punëdhënësi i cenon të drejtat e punëmarrësve jo vetëm duke vepruar në kundërshtim me ligjin, por edhe duke mos i ushtruar kompetencat për të cilat është ngarkuar nga ligji.

Për të njëjtën kërkesë të ankueses, për të cilën ka disponuar më parë njësia e burimeve njerëzore, nëpërmjet shkresës nr.359/22 prot datë 18.09.2023, rezulton të ketë vendimarrje edhe nga ana e organit kolegjal të Komisionit të Konkurencës. Konkretisht me vendimin nr.1003 (nr.359/23 prot), datë 18.09.2023, Komisioni i Konkurencës, ka vendosur largimin e ankueses nga funksioni i Sekretares së Përgjithshme të Autoritetit të Konkurencës dhe përfundimin e marrëdhënies së saj të punës me institucionin e Autoritetit të Konkurencës.

Bazuar në parashikimet e mësipërme ligjore, si dhe për të gjitha arsyet dhe rrethanat e konstatuara më sipër, Komisioneri vlerëson se, vendimi nr.1003 (nr.359/23 prot) datë 18.08.2023, i Komisionit të Konkurencës, është në tejkalim të kompetencave të këtij organi, pasi

sipas legjislacionit të shërbimit civil një vendimarrje e tillë i takon njësisë së burimeve njerëzore. Në lidhje me këtë moment, konstatohet se, nga kërkesa e depozituar nga ankuesja në kuadër të procedurës për pezullim për shkak të ligjit, është nxjerrë nga konteksti një pjesë e saj, duke e keqinterpretuar, kërkesën e ankueses si dorëheqje, kur në fakt, referuar përmbajtjes tërësore të shkresave të ankueses dhe bazës ligjore të vendosur prej saj, tregojnë qartë se nuk kemi të bëjmë me një kërkesë për dorëheqje nga shërbimi civil nga ana e ankueses.

Nga aktet e administruara, konstatohet se, pas përfundimit të marrëdhënies së punës së ankueses me Autoritetin e Konkurrencës dhe pasi ajo ka bërë dorëzimin e rregullt të detyrës, fakt ky që rezulton sipas procesverbalit datë 18.07.2023, të mbajtur midis ankueses dhe punonjësve të institucionit të Autoritetit të Konkurrencës, punëdhënësi/Autoriteti i Konkurrencës, nuk ka plotësuar librezën e punës së ankueses. Ankuesja pretendon se, nga ana e institucionit nuk është bërë asnjë veprim për plotësimin e librezës së punës nga personat përgjegjës, si dhe vendosja e vulës së institucionit për shkak se është dhënë urdhër verbal nga ana e z. D.B . Pretendimin në lidhje me mosplotësimin e librezës së punës, ankuesja ia ka paraqitur institucionit të Autoritetit të Konkurrencës nëpërmjet shkresës nr.359/33 prot datë 29.08.2023. Ankuesja nuk ka marrë përgjigje nga ana e institucionit në lidhje me këto pretendime.

Komisioneri vlerëson se, librezja e punës është një dokument që i përket punëdhënësit dhe në momentin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, punëdhënësi ka detyrimin që të bëjë plotësimin e këtij dokumenti.

- Në lidhje me trajtimin e padrejtë dhe të disfavorshëm të ankueses në kuadër të vijimit të ecurisë disiplinore në ngarkim të saj, procedurë e finalizuar me dhënien e masës disiplinore “Largim nga Shërbimi Civil”.

Në bazë të akteve të administruara rezulton se, pavarësisht se ankuesja ka ndërprerë marrëdhëniet e punës me institucionin e Autoritetit të Konkurrencës në datën 18.07.2023, procedimi disiplinor në ngarkim të saj filluar me shkresën nr.359/3 prot datë 29.06.2023, të Komisionit Disiplinor, ka vazhduar.

Pas largimit të ankueses nga detyra e Sekretares së Përgjithshme të institucionit të Autoritetit të Konkurrencës në datën 18.07.2023, me shkresën nr.359/31 prot., datë 21.08.2023 me lëndë “Njoftim për vijimin e procedimit disiplinor” të nënshkruar nga z.D.B , në cilësinë e Kryetarit të Komisionit Disiplinor, ankuesja është njoftuar se, në mbledhjen e datës 28.07.2023, Komisioni i Disiplinës i ngritur me urdhrin nr.359/1 datë 27.06.2023, i ndryshuar, kishte vendosur që të njoftonte ankuesen për të paraqitur pretendimet/prapësimet e saj në lidhje me procedurën disiplinore në mbledhjen e datës 08.09.2023, ora 10:00.

Në përgjigje të këtij njoftimi të bërë nga Kryetari i Komisionit të Disiplinës, z.D.B , ankuesja me shkresën e datës 07.09.2023, i është drejtuar institucionit të Autoritetit të Konkurrencës, duke

kërkuar anulimin e akteve të prodhuara gjatë procedimit disiplinor, si akte të cilat vijnë në kundërshtim me ligjin.

Komisioni Disiplinor ka vijuar me procedurën disiplinore, duke ndryshuar objektin e ecurisë disiplinore në ngarkim të ankueses, duke përfshirë si shkelje të pretenduara se janë konsumuar nga ana e saj edhe informacionin me nr.359/38 prot datë 08.09.2023, të përgatitur nga nëpunësit Th.K dhe A.P, në të cilin evidentohet moskryerja e detyrave nga ankuesja gjatë ushtrimit të detyrës së Sekretares së Përgjithshme, pranë Autoritetit të Konkurrencës.

Në kundërshtim me pikën 15, të VKM-së nr.115, datë 05.03.2014, ku parashikohet se: “15. Në përfundim të hetimit administrativ, sipas pikës 14 të kreut II të këtij vendimi, organi disiplinor i vë në dispozicion nëpunësit që po procedohet materialet e mbledhura gjatë këtij hetimi.”, Komisioni i Disiplinës, në cilësinë e organit disiplinor, nuk i ka vendosur në dispozicion ankueses informacionin e datës 08.09.2023, duke i cenuar të drejtën për t’u njohur me ndryshimin e objektit të ecurisë disiplinore në ngarkim të saj dhe rrjedhimisht me të drejtën për t’u mbrojtur.

Sa më sipër, Komisioneri konstatoi se, procesi i fillimit të ecurisë disiplinore dhe përbërja e organit disiplinor nuk është bërë në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Për pasojë çdo akt, veprim apo vendimarrje e kryer gjatë kësaj procedure disiplinore, është marrë në kundërshtim me parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Komisioneri vlerëson se, vijimi i ecurisë disiplinore ndaj ankueses nga ana e Komisionit të Disiplinës, të krijuar me urdhrin nr.20, datë 27.06.2023, nuk duhet të kishte vijuar, për shkak se, ky organ disiplinor, nuk ishte i krijuar në përputhje me kërkesat ligjore për organet e disiplinës në shërbimin civil. Për të vijuar me procedimin disiplinor në ngarkim në ankueses, kërkesa për fillimin e ecurisë disiplinore duhet të paraqitej nga një prej subjekteve të parashikuara në pikën 4, të nenit 59, të ligjit nr.152/2013 dhe titullari i institucionit të Autoritetit të Konkurrencës, duhet të kishte rregulluar përbërjen e Komisionit të Disiplinës, sipas kërkesave ligjore të përcaktuara në pikën 3, të Kreut 1, të VKM-së Nr.115/2014. Fillimi i ecurisë disiplinore dhe krijimi i organit të disiplinës në përputhje me kërkesat e parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë disiplinën në shërbimin civil, do të përlligjte vazhdimin e procedurës disiplinore në ngarkim të ankueses, në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se, aktet e nxjerra nga Komisioni i Disiplinës gjatë procedurës disiplinore në ngarkim të ankueses dhe vendimi i Komisionit të Disiplinës, pranë institucionit të Autoritetit të Konkurrencës me nr.1, datë 28.09.2023, nëpërmjet të cilit është vendosur marrja e masës disiplinore “*largim nga shërbimi civil*” ndaj ankueses, nuk janë në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

- *Vlerësimi i ligjshmërisë së akteve të nxjerra nga institucioni i Autoritetit të Konkurrencës, nga ana e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil (KMSHC), në cilësinë e organit të pavarur të specializuar në fushën administrimit të shërbimit civil.*

Rezulton se, procedura e ndjekur dhe aktet e nxjerra nga nëpunësit e ngarkuar prej ligjit me detyra specifike gjatë zhvillimit të ecurisë disiplinore ndaj ankueses, si dhe dinamika me të cilën ka ndryshuar marrëdhënia e punësimit të ankueses pranë Autoritetit të Konkurrencës, kanë qenë objekt shqyrtimi nga ana e KMSHC.

Referuar nenit 11, të ligjit nr.152/2013, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është institucion i pavarur, i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil. KMSHC, mbikëqyr, kryesisht ose me kërkesë të institucioneve, zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë. (neni 14, pika 1, të ligjit nr.152/2013. Sipas pikës 2, të nenit 14, të ligjit nr.152/2013, në ushtrimin e kompetencave, KMSHC, ndër të tjera, kryen hetim të plotë administrativ, sipas Kodit të Procedurave Administrative. Në nenin 15 “Mbikëqyrja”, të ligjit nr.152/2013, bëhet përcaktimi vijues:

“1. Nëse gjatë mbikëqyrjes, Komisioneri çmon se ka shkelje të ligjit në administrimin e shërbimit civil, me vendim me shkrim, paralajmëron institucionin përkatës, duke i lënë detyrat për përmirësimin e situatës dhe duke përcaktuar një afat të arsyeshëm për zbatimin e tyre.

2. Në rast të moszbatimit të vendimit të dhënë, sipas pikës 1 të këtij neni, Komisioneri mund të gjobisë nëpunësin përgjegjës për moszbatimin e masave. Masa e gjobës është nga 20 për qind deri në 30 për qind të pagës mujore të nëpunësit përgjegjës. Në rast të moszbatimit të mëtejshëm të vendimit, Komisioneri mund të vendosë një gjobë tjetër deri në 50 për qind të pagës mujore të personit përgjegjës.

3. Vendimi për dhënien e gjobës mund të ankimohet në gjykatën kompetente për mosmarrëveshjet administrative.”

Në përfundim të proceseve, të zhvilluara nga ana e institucionit të KMSHC, rezulton se ky institucion i pavarur ka nxjerrë tre vendime paralajmëruese, për institucionin e Autoritetit të Konkurrencës dhe nëpunësit përgjegjës, të cilat janë, vendimi nr.67, datë 14.07.2023, vendimi nr.71, datë 25.07.2023 dhe vendimi nr.91 datë 02.11.2023. Nëpërmjet këtyre tre vendimeve, KMSHC, ka konstatuar se, procesi i fillimit të ecurisë disiplinore në ngarkim të ankueses, aktet e nxjerra nga organi i disiplinës, ndryshimi i ecurisë së marrëdhënies në shërbimin civil për ankuesen në pozicionin e punës “Sekretar i Përgjithshëm” pranë Autoritetit të Konkurrencës, nëpërmjet procedurës së ndjekur për pezullimin nga shërbimi civil, si dhe procesi i aplikimit të masës disiplinore “largim nga shërbimi civil” në ngarkim të ankueses si ish Sekretare e Përgjithshme pranë Autoritetit të Konkurrencës, janë kryer në shkelje të legjislacionit në fuqi që rregullon shërbimin civil. Nëpërmjet tre vendimarrjeve të tij, institucioni i KMSHC-së, ka konstatuar pavlefshmërinë absolute të akteve të nxjerra nga nëpunësit e ngarkuar prej ligjit me detyra specifike gjatë zhvillimit të këtyre procedurave ligjore dhe ka paralajmëruar institucionin e Autoritetit të Konkurrencës për rregullimin e situatave të ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në lidhje me procedurat në ngarkim të ankueses.

Vendimet e KMSHC nuk janë zbatuar nga institucioni i Autoritetit të Konkurrencës dhe nëpunësit përgjegjës dhe nuk rezulton që të ketë ndonjë vendim gjykatë të formës së prere që i ka shfuqizuar vendimet e këtij institucioni.

Për gjitha sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se ankuesja D.D, i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të disfavorshëm gjatë procedurës së ecurisë disiplinore, ndryshimit të ecurisë së marrëdhënies në shërbimin civil për ankuesen në pozicionin e punës “Sekretar i Përgjithshëm” pranë Autoritetit të Konkurrencës, si dhe aplikimit ndaj saj, në përfundim të procedurës disiplinore, të masës disiplinore “*Largim nga shërbimi civil*”.

B. Shkaku i mbrojtur.

Ankuesja pretendon se është diskriminuar për shkak të “*gjendjes shëndetësore*” dhe “*çdo shkak tjetër*”.

Në lidhje me shkakun e pretenduar të diskriminimit, pala ankuese duhet të provojë *në radhë të parë* se shkakun e pretenduar prej saj është një shkak që gëzon mbrojtje sipas ligjit dhe *në radhë të dytë* duhet të provojë ekzistencën e tij. E njëjta qasja gjen zbatim edhe kur pretendohet se diskriminimi ka ndodhur për më shumë se një shkak.

Në rastin në fjalë, pretendohet se ankuesja është diskriminuar për më shumë se një shkak, për shkak të “*gjendjes shëndetësore*” dhe “*çdo shkak tjetër*”.

Në lidhje me shkakun e “*gjendjes shëndetësore*”, Komisioneri konstaton se, ky shkak është një shkak që gëzon mbrojtje nda diskriminimi, bazuar në nenin 1, të LMD-së.

Në lidhje me provueshmërinë e shkakut të “*gjendjes shëndetësore*”, nga aktet e administruara konstatohet se, ankuesja në datat 26-27.06.2023, 29-30.06.2023, 07.07.2023 dhe 14.07.2023, ka qenë në kushtet e paaftësisë së përkohshme në punë, konfirmuar nëpërmjet raporteve mjekësore. Në këto kushte, Komisioneri konsideron se shkakun e gjendjes shëndetësore, rezulton i provuar.

Referuar parashtrimeve të ankuses, kjo e fundit e lidh pretendimin për diskriminim në kuadër të termit “*çdo shkak tjetër*” me natyrën e funksionit që ajo ka mbajtur pranë institucionit të Autoritetit të Konkurrencës, konkretisht “Sekretare e Përgjithshme” dhe njëkohësisht drejtuese e Sekretariatit në Autoritetin e Konkurrencës, kompetencat e të cilit, janë parashikuar në mënyrë të posaçme në nenin 27 dhe 29 të ligjit nr.9121, datë 28.07.2023 “*Për Mbrojtjen e Konkurrencës*”. Pikërisht për shkak të natyrës së funksionit që ka ushtruar, ankuesja pretendon se, në shtator të vitit 2021, gjatë ushtrimit të detyrës pranë Autoritetit të Konkurrencës, Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, i cili drejtohej nga ana e saj në detyrën e Sekretares së Përgjithshme, realizoi një hetim në tregun e importit, prodhimit dhe tregimit të miellit. Në përfundim të këtij hetimi, nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës dhe ankuesja si Sekretare e Përgjithshme, u propozua gjobitja e shoqërive që operonin në këtë treg për shkelje ligjit 9121/2003 “*Për Mbrojtjen e*

konkurencës”. Komisioni i Konkurencës, me vendimin e datës 29.09.2021, me shumicën e votave të antarëve të këtij komisioni, z.D.B , znj. A.B , znj. L.M , vendosi, të mbajë në monitorim këtë treg edhe për 2022. Që nga ky moment 3 antarët e Komisionit të Konkurencës të cilët nuk votuan për gjobë përkatësisht z.D.B , znj. A.B , znj. L.M kanë vijuar nje marrëdhënie të tensionuar me ankuesen si drejtuese e Sekretariatit.

Neni 1, i LMD, është në linjë me parashikimet e nenit 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ-së), e cila sanksionon mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë të hapur shkaqesh. Krahas praktikës kombëtare, Komisioneri i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Ky referim bëhet duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme. Në referim edhe të evokimit që i bëhet Konventës në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ajo merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilës bëhet interpretimi i Konventës, ka fuqinë e Konventës.

Sipas praktikës së GJEDNJ-së, neni 14, i KEDNJ-së nuk ndalon të gjitha dallimet në trajtim, por vetëm ato diferenca të bazuara në një karakteristikë personale të identifikueshme, objektive ose personale, ose "status", me të cilin personat ose grupet e personave janë të dallueshëm nga njëritjetri.³ Gjykata ka theksuar se fjalës "shkak/status tjetër" në përgjithësi i është dhënë një kuptim i gjerë.⁴ Interpretimi i këtij nocioni “*nuk është kufizuar në karakteristika që janë personale në kuptimin që ato janë të lindura apo të pandashme*”.⁵

Në çështjen Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar (paragrafi 60) GJEDNJ-ja është shprehur se: “*Pyetja nëse ekziston një ndryshim në trajtim bazuar në një karakteristikë personale ose të identifikueshme, në çdo rast është një çështje që duhet vlerësuar duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe duke pasur parasysh se qëllimi i Konventës është të garantojë jo të drejta që janë teorike ose jo reale, por të drejta që janë praktike dhe efektive*”.

Nga aktet e administruara rezulton e provuar se, me vendimin nr.839, datë 29.09.2021, Komisioni i Konkurencës, në Autoritetin e Konkurencës, me shumicën e votave të antarëve të këtij komisioni, z.D.B , znj. A.B , znj. L.M , ka arritur në një vendimarrje të ndryshme nga hetimi dhe propozimi i bërë nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurencës, i drejtuar nga ankuesja, si Sekretare e Përgjithshme. Rezulton se, anëtarët e Komisionit të Konkurencës, znj. Juliana Latifi, Kryetare e Komisionit të Konkurencës në atë kohë dhe anëtari z. Eduard Ypi, kanë dalë

³ Shih: *Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar*, prg 55; *Kjeldsen Busk Madsen dhe Pedersen kundër Danimarkës*, prg 56; *Carson dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, prg 61 dhe 70; *Novruk dhe të tjerë kundër Rusisë*, prg. 90.

⁴ Shih: *Carson dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, prg 70.

⁵ Shih: *Biao kundër Danimarkës*, aplikimi nr. 38590/10, prg.89.

me mendim pakice, duke mbështetur hetimin dhe propozimin e Sekretariatit, të drejtuar nga ankuesja si Sekretare e Përgjithshme.

Në parashtrimet e tij z.B. , pranon faktin se vendimarrja e Komisionit të Konkurencës, e datës 29.09.2021, ka qenë një vendimarrje e tensionuar. Sipas tij, ditët në vijim kanë qenë një situatë jo normale e krijuar nga ish Kryetarja e asaj kohe, duke bërë që z.B. dhe dy anëtarët e tjerë të Komisionit të Konkurencës ose nuk shkonin në punë ose mbylleshin në zyrë dhe nuk kishin asnjë komunikim me punonjësit e Autoritetit të Konkurencës, të cilët nuk guxonin që t’iu flisnin.

Komisioneri vlerëson se, për sa kohë që vendimarrja e datës 29.09.2021 e Komisionit të Konkurencës ka qenë një vendimarrje e tensionuar, e cila ka prodhuar një situatë jo normale, midis anëtarëve të Komisionit të Konkurencës që kishin votuar ndryshe nga ish Kryetarja, e cila ishte bazuar në hetimin dhe propozimin e Sekretariatit, të drejtuar nga ankuesja si Sekretare e Përgjithshme, ky fakt konfirmon pretendimin e ngritur nga ankuesja, se vendimarrjen e datës 29.09.2021, e Komisionit të Konkurencës, ka krijuar një marrëdhënie të tensionuar dhe konfliktuale midis palëve që kanë mbajtur qëndrime të kundërta në këtë vendim të Komisionit të Konkurencës.

Komisioneri gjykon se, trajtimi i padrejtë dhe i pafavorshëm i personave për shkak të “qëndrimit të kundërt gjatë ushtrimit të kompetencave dhe përmbushjes së detyrave të përcaktuara me ligj”, duhet të gëzojnë mbrojtje nga diskriminimi dhe se ekzistojnë prova të mjaftueshme të cilat tregojnë se ankuesja e mbart këtë shkak.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë me shkaqet e mbrojtura.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjisllacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Ky parim përshkon edhe nenin 49 të Kushtetutës sipas të cilit “*Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional*”.

Gjykata Kushtetuese⁶, ka mbajtur qëndrimin se: “*E drejta për punë, që garanton neni 49/1 i Kushtetutës, përfshin zgjedhjen e profesionit, vendin e punës dhe sistemin e kualifikimit profesional me qëllim sigurimin e mjeteve të jetesës në mënyrë të ligjshme. Zgjedhja e*

⁶ Vendimi nr. 20, datë 11.07.2006, i Gjykatës Kushtetuese.

profesionit, siç parashikohet nga dispozita kushtetuese, përbën një të drejtë të individit në kuptimin, që ai i përkushtohet një veprimtarie për të siguruar mjetet e jetesës. Kjo e drejtë e individit për të përfituar me punë të ligjshme fiton rëndësi edhe nga pikëpamja sociale, pasi puna si profesion është një vlerë edhe për kontributin që i sjell shoqërisë në tërësi. E drejta për punë dhe liria e profesionit nënkuptojnë të drejtën e individit për të ushtruar çdo veprimtari të ligjshme që i sjell të ardhura dhe që nuk ka afat të përcaktuar, me përjashtim të rregullimeve të veçanta ligjore. Në këtë kuptim, veprimi i organeve shtetërore që sjell pasoja të drejtpërdrejta në pengimin e veprimtarisë profesionale përbën cenim të kësaj lirie veprimi. Garancia që Kushtetuta i jep individit lidhur me të drejtën për punë dhe lirinë e profesionit ka si qëllim mbrojtjen e këtyre nga kufizimet e papërligjura të shtetit. Liria e profesionit nuk është thjesht një e drejtë për të pasur një vend pune. Ajo nuk duhet kuptuar vetëm si e drejtë sociale, por dhe si liri negative që nuk lejon ndërhyrjen ose pengimin e shtetit gjatë ushtrimit të saj. Përcaktimi që neni 49 i Kushtetutës i bën të drejtës për punë duhet të merret në kuptim të dyfishtë. Ajo përbën një detyrim pozitiv që kërkon angazhimin shtetëror për të krijuar kushte të përshtatshme për realizimin e një të drejte të tillë, por edhe detyrim negativ, i cili kërkon mosndërhyrjen e shtetit për të cenuar këtë të drejtë”.

Në rastin në fjalë kemi të bëjmë me një marrëdhënie pune ndërmjet shtetit dhe një individi/nëpunësit civil, që përfshihet në shërbimin civil dhe rregullohet nga ligji nr.152/2013. Referuar nenit 5, të ligjit nr.152/2023, parimi i mosdiskriminimit, është një nga parimet që udhëheq administrimin e shërbimit civil.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-ja), nuk parashikon të drejtën për punë si një të drejtë të veçantë, por çështjet e punës trajtohen nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ-ja) si çështje që hyjnë në sferën e veprimit të nenit 8, “*E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare*”. Neni 14 i KEDNJ-së ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, bazuar në një listë të hapur shkaqesh. Ndërkohë Protokollit 12-të i Konventës, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, shtrihet përtej të drejtave të mbrojtura shprehimisht nga KEDNJ. Në veçanti, fusha e mbrojtjes sipas nenit 1, të Protokollit të 12, të KEDNJ përfshin rastet kur personi është diskriminuar: “*a) në gëzimin e çdo të drejte ligjore të njohur shprehimisht me ligj të veçantë; b) në gëzimin e çdo të drejte që rrjedh nga një detyrim i qartë i autoritetit publik sipas legjislacionit të brendshëm, sa kohë autoriteti ka detyrimin të dëshmojë një sjellje të caktuar mbi bazën e ligjit të brendshëm; c) nga autoriteti publik në ushtrimin e kompetencës diskrecionare; d) nga çdo akt apo mosveprim tjetër i autoritetit publik”.*

E drejta për punë dhe mbrojtja nga diskriminimi në gëzimin e kësaj të drejte parashikohet edhe në akte të tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria të tilla si:

“Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore”⁷, i cili sanksionon të drejtën për punë në nenin 6, të tij. Sipas këtij akti ndërkombëtar në fushën e të drejtave të njeriut, i cili është ratifikuar nga vendi ynë, parashikohet se, e drejta për punë përfshin të drejtën e secilit për të pasur mundësinë e sigurimit të jetesës, duke punuar punën e pranuar lirisht dhe marrjen e masave të përshtatshme për ta mbrojtur këtë të drejtë. Sipas nenit 2/2, të Paktit, të drejtat e parashikuara në këtë Pakt duhet të garantohen pa asnjë diskriminim, bazuar në një listë të hapur shkaqesh.

Konventa Nr.111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”⁸, përcakton parimin e barazisë së mundësive dhe të trajtimit në fushën e punësimit dhe të profesionit për të gjithë individët, pa asnjë lloj diskriminimi dhe bazuar në një listë të hapur shkaqesh.

Karta Sociale Europiane⁹ në nenin 1, pika 2, parashikon: “Me synimin që të sigurohet ushtrimi efektiv i së drejtës për punë, Palët angazhohen.....2 të mbrojnë efektivisht të drejtën e punëtorit për të fituar jetesën e tij në një punë në të cilën ka hyrë lirisht...” Ky parashikim, është interpretuar vazhdimisht nga Komiteti Evropian i të Drejtave Sociale (KEDS) si vendosje e një të drejte për të mos u diskriminuar në punësim¹⁰. Garancitë për mbrojtjen nga diskriminimi parashikohen në nenin E), Pjesa V, të Kartës Social Europiane, ku përcaktohet mbrojtja nga diskriminimi bazuar në një listë të hapur shkaqesh.

Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllorja për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Ky parim presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta dhe vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive mund të përlligjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë (Vendimet nr. nr. 31 datë 04.10.2021, nr. 27, datë 29.06.2021; nr. 20, datë 20.04.2021; nr. 10, datë 29.02.2016; nr. 48, datë 15.11.2013 të Gjykatës Kushtetuese). Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, duke sanksionuar parimin e barazisë para ligjit, nuk i ka dhënë atij kuptimin e një të drejte absolute, sepse ajo ka përcaktuar njëkohësisht edhe kushtet e kufizimit në ushtrimin e kësaj të drejte. Paragrafi i tretë i nenit 18 të Kushtetutës pranon kufizimet e të drejtës për barazi me përmbushjen e disa kushteve të posaçme, pikërisht të përlligjes së arsyeshme dhe objektive. (vendimi nr. 19, datë 09.07.2009, i Gjykatës Kushtetuese). Ky parim kërkon që të gjitha subjektet të trajtohen në mënyrë të njëjtë, por nuk formulon ndalime që të mund të bëhen trajtime të diferencuara kur individët e grupet nuk ndodhen në kushte të njëjta a të ngjashme, apo kur ka justifikim të arsyeshëm e objektiv, duke vendosur një raport të arsyeshëm dhe përpjesëtimor midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet. (Vendimet nr.18, datë 29.07.2008 dhe nr.19, datë 09.07.2019 të Gjykatës Kushtetuese).

⁷ Ratifikuar me ligjin nr. 7511 datë 08.08.1991.

⁸ Ratifikuar me ligjin nr. 8086, datë 13.03.1996.

⁹ Ratifikuar me ligjin nr. 8960, date 24.10.2002

¹⁰ Shih: Sidabras dhe Džiautas kundër Lituanisë, prg 30.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se, trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet¹¹. Referuar jurisprudencës së GJEDNJ-së, diskriminimi i drejtpërdrejtë, edhe pse neni 14 i KEDNJ-së nuk jep një përkufizim të tij, konsiderohet si “dallim në trajtim i personave në situata të njëjta ose të ngjashme” dhe “bazuar në një karakteristikë ose “status” të dallueshëm”¹²

LMD, është një ligj i cili është miratuar mbështetur dhe në zbatim të nenit 18 të Kushtetutës. Në linjë me interpretimin e Gjykatës Kushtetuese dhe GJEDNJ-së, sipas LMD, jo çdo dallim apo ndryshim i trajtimit konsiderohet diskriminim. Në bazë të nenit 6, të LMD përcaktohet se: *“Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi”*.

Sipas nenit 3, pika 1, të LMD të ndryshuar, diskriminimi përkufizohet: *““Diskriminimi” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”*.

LMD parashikon dhe jep përkufizimin e disa formave nëpërmjet të cilave shfaqet diskriminimi. Referuar nenit 3, pikat 2 dhe 15, të LMD, përcaktohet se: *“2. “Diskriminim i drejtpërdrejtë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji.....15. “Udhëzim për të diskriminuar” është një udhëzim ose kërkesë për të diskriminuar një ose më shumë persona, në bazë të shkaqeve të përmendura në nenin 1 të këtij ligji.”*

Në shumicën e çështjeve të diskriminimit, pala ankuese e ka të vështirë apo të pamundur t'i mbledhë provat, ndonjëherë provat e drejtpërdrejta as nuk ekzistojnë. Subjektet që konsumojnë sjelljen diskriminuese nuk e pranojnë asnjëherë se kanë diskriminuar. Për të kompensuar këtë disavantazh të madh, legjislacioni ka parashikuar parimin e zhvendosjes së barrës së provës. Parimi i zhvendosjes së barrës së provës është një parim i konsoliduar në legjislacionin e BE-së

¹¹ Shih: *Molla kundër Greqisë*, Vendim i Dhomës së Madhe, 2018, prg. 135; *Fábián kundër Hungarisë*, Vendim i Dhomës së Madhe 2017, prg. 113; *Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1985, prg.72.

¹² Shih: *Biao kundër Danimarkës, Dhoma e Madhe, datë 14.05.2016, § 89, Carson dhe të Tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Dhoma e Madhe 2010, datë 16.03.2010, prg. 61.

dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së. KEDS gjithashtu ka pranuar që në çështjet e diskriminimit, barra e provës nuk duhet të varet plotësisht nga ankuesi, por duhet të jetë objekt i një rregullimi të posaçëm. Ky rregullim i posaçëm në lidhje me barrën e provës pasqyrohet në nenin nenin 33, pika 7/1 të LMD, ku parashikohet se : “7/1. Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim.” I njëjti rregullim në lidhje me barrën e provës, parashikohet edhe në nenin 82, pika 2, të Kodit të Procedurave Administrative, ku përcaktohet se: “2. Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj.”

Sa më sipër, pala ankuese duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek subjekti që pretendohet se ka kryer diskriminim, i cili duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

- Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
- Ose duke provuar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse subjekti që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë njërën nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjëse për diskriminim.¹³

Parimi i zhvendosjes së barrës së provës, në çështjet e diskriminimit është i ngjashëm me atë të supozimeve të marra si të vërteta deri në vërtetimin e të kundërtës - *praesumptio iuris tantum* dhe po kështu bazohet tek logjika e përdorur për vendosjen e lidhjes mes fakteve që tregojnë trajtim të mundshëm diskriminues dhe ekzistencës së këtij trajtimi në realitet. Barra e provës zhvendoset dhe pala kundër të cilës është paraqitur ankesa, për të vërtetuar se nuk ka patur diskriminim, duhet të rrëzojë supozimin faktik se ka patur diskriminim.

Sipas praktikës gjyqësore të vendosur nga GJEDNJ, prova, mund të rrjedhë nga bashkëekzistenca e konkluzioneve mjaftueshmërisht të forta, të qarta dhe të përputhshme ose e supozimeve të ngjashme të faktit të pakundërshtuara. Për më tepër, niveli i bindjes së nevojshme për të arritur një përfundim të caktuar dhe, në lidhje me këtë, shpërndarja e barrës së provës, janë të lidhura thelbësisht me specifikën e fakteve, natyrën e pretendimit të bërë dhe të drejtën e pretenduar¹⁴.

¹³ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

¹⁴ GJEDNJ, *Nachova dhe të tjerët kundër Bullgarisë* (GC) paragrafi 147, (ECtHR, *Nachova and others v. Bulgaria* [GC] (Nos. 43577/98 and 43579/98), 6 July 2005). Kjo përsëritet në çështjen e GJEDNJ-së, *Timishev kundër Rusisë*

Në aspektin procedural, si fillim duhet të provojë se i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e diferencuar, është shkaku i mbrojtur nga diskriminimi dhe në kushtet kur arrihet ky nivel provueshmërie barra e provës për të provuar të kundërtën, që veprimet nuk përbëjnë diskriminim i bie palës tjetër.

Komisioneri çmon të nevojshme të theksoj se, është pikërisht bazuar në standardin e mësipërm të të provuarit, që do të shqyrtojë dhe do të konkludojë në lidhje me bazueshmërinë e pretendimeve për diskriminim të parashtruara në këtë ankesë.

Sa më sipër, Komisioneri arriti në përfundimin se ankuesja D.D, i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm, gjatë procedurës së ecurisë disiplinore, ndryshimit të ecurisë së marrëdhënies në shërbimin civil për ankuesen në pozicionin e punës “Sekretar i Përgjithshëm” pranë Autoritetit të Konkurrencës, nëpërmjet procedurës së ndjekur për pezullimin nga shërbimi civil, si dhe aplikimit ndaj saj të masës disiplinore “Largim nga shërbimi civil”.

Nga ana tjetër, rezultuan të bazuara dhe të provuar shkaqet e diskriminimit të pretendua nga ankuesja, siç është *gjendja shëndetësore* dhe në kuadër të “*çdo shkaku tjetër*”/“*qendrimit të kundërt gjatë ushtrimit të kompetencave dhe përmbushjes së detyrave të përcaktuara me ligj*”. Në këto kushte, Komisioneri do të marrë në analizë lidhjen midis trajtimit të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë, të cilit i është nënshtruar ankuesja, nga ana e subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa, dhe shkaqeve të pretenduara të diskriminimit.

C.1 Lidhja e trajtimit të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë të ankueses në lidhje me shkakun e “*gjendjes shëndetësore*”.

Gjatë procedurës hetimore të shqyrtimit të ankesës nuk u arrit të provohej që gjendja shëndetësore e ankueses ka shërbyer si shkak që ajo është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme. Për rrjedhojë, Komisioneri vlerëson se, pretendimet e ankueses për diskriminim bazuar në këtë shkak, nuk krijojnë prezumimin mbi bazën e provave të drejtpërdrejta apo të tërthorta të administruara gjatë shqyrtimit, që sjellja e punëdhënësit kundrejt saj të jetë motivuar nga shkaku i gjendjes shëndetësore.

Përfundimisht, Komisioneri vlerëson se, pretendimi i ankueses se është diskriminuar për shkak të gjendjes shëndetësore, është i pabazuar në prova dhe në ligj.

(Numrat 55762/00 dhe 55974/00), 13 Dhjetor 2005, paragrafi 39 (ECtHR, *Timishev v. Russia* (Nos. 55762/00 and 55974/00), 13 December 2005), dhe GJEDNJ, *D.H dhe të tjerët kundër Republikës Çeke* [GC] (Nr. 57325/00), 13 Nëntor 2007, paragrafi 178 (ECtHR, *D.H. and others v. the Czech Republic* [GC] (No. 57325/00), 13 November 2007).

C.2 Lidhja e trajtimit të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë të ankueses në kuadër të termit “çdo shkak tjetër”/“qendrimin të kundërt gjatë ushtrimit të kompetencave dhe përmbushjes së detyrave të përcaktuara me ligj”.

Ankuesja pretendon se është ekspozuar ndaj trajtimit të padrejtë dhe të disfavorshëm nga ana e Kryetarit të Komisionit të Konkurrencës z. D.B dhe se ky trajtim ka si shkak qendrimin e kundërt me këtë të fundit, që ankuesja ka mbajtur gjatë ushtrimit të kompetencave dhe përmbushjes së detyrave të përcaktuara me ligj për Sekretarin e Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës, gjatë vendimarrjes së Komisionit të Konkurrencës të datës 29.09.2021.

Ankuesja pretendon se, për shkak të vendimarrjes së mësipërme, midis saj dhe anëtarëve të Komisionit të Konkurrencës, që kishin mbajtur qendrim të ndryshëm nga propozimi ankueses si Sekretare e Përgjithshme dhe drejtuese e Sekretariatit të Konkurrencës, ka vijuar një marrëdhënie e tensionuar. Kjo marrëdhënie e tensionuar është përshkallëzuar derisa në datën 26.06.2023, nga ana e Kryetarit të Komisionit të Konkurrencës z.D.B , ankueses i është kërkuar dorëheqja nga pozicioni i Sekretares së Përgjithshme brenda 24 orëve, në të kundërt ndaj saj do të fillonte procedimi disiplinor.

Referuar parashtrimeve të depozituar nga z.B. , ky i fundit konfirmon faktin se, në datën 26.06.2023, ka patur një takim me znj. D. , të cilës i ka “ofruar” që të largohej me dorëheqje nga detyra, si një “formë e butë largimi”, pasi ai kishte humbur besimin te znj.D. dhe nuk mund të punonin më bashkë, për shkak se kishte marrë dijeni se nga ana e ankueses gjatë ushtrimit të detyrës ankuesja kishte tjetërsuar faktet dhe ligjin.

Në kuadër të marrëdhënies në shërbimin civil, disiplina e nëpunësve civile është e rregulluar në bazë të ligjit nr.152/2013 dhe akteve nënligjore të data në zbatim të tij. Referuar kompetencave dhe procedurës për masat disiplinore, parashikuar nga neni 59, i ligjit nr.152/2013, por në tërësi në frymën e parashikimeve që bëhen në dispozitat e këtij ligji që rregullojnë disiplinën në shërbimin civil, nëpunësi civil është përgjegjës për shkeljen me faj të detyrimeve të nëpunësit sipas ligjit dhe se, subjektet të cilave ligji iu ka njohur të drejtën për të kërkuar apo filluar ecurinë disiplinore ndaj nëpunësit civil e kanë detyrim të kërkojnë apo fillojnë ecurinë disiplinore ndaj nëpunësit civil, i cili pretendohet se ka shkelur me faj detyrimet ligjore. Në këtë kuptim, z.B. , qoftë të cilësinë e pretenduar të eprorit direkt të ankueses, qoftë në cilësinë e një zyrtari me detyra kontrolli hierarkik mbi nëpunësin civil, nuk ka të drejtë që të “*ofrojë mundësi për forma të buta largimi nëpërmjet dorëheqjes*”. Pra, z. B. nëpërmjet “ofrimit të mundësisë për forma të buta largimi nëpërmjet dorëheqjes” ka synuar përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil të ankueses, në dukje në mënyrë të vullnetshme nëpërmjet dorëheqjes. Megjithëse pranimi i dorëheqjes apo çdo veprim tjetër që lidhet me marrëdhënien e punës të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës është kompetencë e Komisionit të Konkurrencës dhe jo posaçërisht e Kryetarit të Komisionit, sikurse shprehet edhe z.B. në parashtrimet e tij.

Në mungesë të dorëheqjes nga ana e ankueses, z. B. deklaroi se ka thirrur anëtarët e Komisionit të Konkurrencës, të cilëve iu ka bërë me dije se i kishte kërkuar ankueses dorëheqjen nga detyra si Sekretare e Përgjithshme për veprime dhe mosveprime në kundërshtim me ligjin, nga të cilët, ka marrë mbështetje dhe në vijim, i është kërkuar po nga anëtarët e Komisionit të Konkurrencës, që veprimet dhe mosveprimet e ankueses të analizoheshin nga Komisioni Disiplinor, i kryesuar vetëm prej tij e jo prej dikujt tjetër, duke qenë se znj.D. ishte punonjësja më e lartë në shërbimin civil në Autoritetin e Konkurrencës dhe Komisioni i Disiplinës nuk kishte si të drejtohej nga një vartës i saj.

Këto pretendime të z. B. nuk rezultuan të provuara gjatë shqyrtimit të ankesës, pasi nuk u administrua ndonjë akt, ku vullneti i Komisionit të Konkurrencës, në cilësinë e eprorit direkt të ankueses të ketë kërkuar fillimin e ecurisë disiplinore në ngarkim të ankueses apo të ketë autorizuar Kryetarin e Komisionit, z. B. , për të paraqitur një kërkesë të tillë në emër të Komisionit të Konkurrencës apo për të përfaqësuar Komisionin e Konkurrencës, në cilësinë e eprorit direkt të ankueses në procedurën disiplinore në ngarkim të saj.

Nëpërmjet veprimeve të ndërmarra nga z. B. dhe në mungesë të materializimit të vullnetit të autoritetit përgjegjës sikurse është Komisioni i Konkurrencës si organ kolegjal përbërë nga pesë anëtarë, që mund të disponojë në lidhje me marrëdhënien e punës së ankueses si Sekretare e Përgjithshme e Autoritetit të Konkurrencës, përforcohet pretendimi se është pikërisht z. B. , ai që ka ndërmarrë fillimin e ecurisë disiplinore ndaj ankueses, në mungesë të kompetencës për një veprim të tillë dhe vetëm pasi ankuesja kishte refuzuar të ashtuquajturën “formë të butë largimi nëpërmjet dorëheqjes”, një veprim ky që vjen në kundërshtim me parashikimet ligjore për disiplinën në shërbimin civil.

Nga aktet shkresore të administruara konstatohet se, edhe pse disa shkresa janë firmosur nga nëpunës të tjerë të Autoritetit të Konkurrencës, sikurse z.Th.K, Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Buxhetit dhe Komunikimit (shkresa nr.359/18 prot datë 17.07.2023) udhëzimet në lidhje me përgjigjen që duhet t’i kthehej ankueses, janë dhënë nga z. B. , fakt ky që rezultoi nga shënimet e vendosura prej tij në pjesën e pasme të shkresave të paraqitura nga ankuesja (shkresa nr.359/17 prot datë 17.07.2023). Kjo korrespondencë ka të bëjë pikërisht me procedurën e ndjekur për pezullimin e ankueses nga shërbimi civil për shkak të ligjit, procedurë e cila në bazë të ligji dhe në dukje është në përgjegjësinë dhe kompetencën e njësisë së burimeve njerëzore, megjithatë, udhëzimet e vendosura nga z.B. , në korrespondencën e sipërcituar, që lidhet me ndjekjen e procedurës nga njësia e burimeve njerëzore, tregojnë se njësia e burimeve njerëzore, në ndjekjen e kësaj procedure, ka qenë e ndikuar nga udhëzimet e titullarit të institucionit z.B. .

Gjithashtu, konstatohet se, edhe në korrespondencën e mbajtur midis ankueses dhe institucionit të Autoritetit të Konkurrencës, pas largimit të saj nga ky institucion në datën 18.07.2023, në lidhje me kërkesat e institucionit ndaj ankueses për t’u paraqitur në institucion me qëllim firmosjen e

dokumentacionit (vlerësime pune dhe procedurë prokurimi) konstatohet se, z. B. , kërkon nga punonjësit që znj. D. të kontaktohet vazhdimisht për të nënshkruar dokumentacionin.

Komisioneri vlerëson se, në momentin që ankuesja është larguar nga institucioni i Autoritetit të Konkurrencës, në datën 18.07.2023 dhe konstatohet se ajo ka kryer dorëzimin e rregullt të detyrës, fakt ky që rezulton i provuar nga procesverbali i mbajtur në datën 18.07.2023 midis ankueses dhe dy punonjesve të tjerë të institucionit, është përgjegjësi e institucionit, që në momentin e largimit të punonjësit nga puna, të sigurojë edhe dorëzimin e rregullt të detyrës. Në rast se provohet që në momentin e largimit nga detyra, punonjësi ka dorëzuar rregullisht detyrën, për pretendime parregullsie të ngritura pas këtij momenti, nuk mund të kërkohej përgjegjësia tek punonjësi, i cili në momentin e largimit ka vepruar në përputhje me kërkesat ligjore të dorëzimit të detyrës.

Pavarësisht dorëzimit të rregullt të detyrës, pas largimit të ankueses në datën 18.07.2023, ajo ka vazhduar të kontaktohet në mënyrë të padrejtë nga ana e ish punëdhënësit dhe nga aktet shkresore të administruara konstatohet se, njoftimet e ankueses për tu paraqitur për nënshkrimin e dokumentacionit kanë qenë kërkesa të drejtëpërdrejta të z. B. , të shprehura nëpërmjet njoftimeve drejtuar ankueses, por edhe shënimeve të vendosur në korrespondencën shkresore të mbajtur me ankuesen.

Gjithashtu, edhe pse ka marrë dijeni nëpërmjet kërkesave të ankueses, se librezja e saj e punës nuk ishte nënshkruar dhe vulosur nga punonjësit përgjegjës të Autoritetit të Konkurrencës, z. B. në cilësinë e titullarit nuk ka ndërmarrë asnjë masë për të adresuar problematikën.

Sikurse deklaroi në parashtrimet e tij, z. B. ka marrë funksionin e Kryetarit të Komisionit të Konkurrencës në datën 09.12.2021. Pas kalimit në këtë detyrë, z.B. deklaroi se bashkëpunimi i tij si titullar me ankuesen si Sekretare e Përgjithshme ka qenë normal dhe profesional. Në mbështetje të këtij pretendimi, z.B. , parashtron se, ankuesja është dërguar me propozimin e tij si titullar në disa shërbime dhe aktivitete pune jashtë shtetit. Komisioneri vlerëson se arsyetimin i z.B. se : *“Për sa kohë që shërbimet jashtë shtetit janë ende forma të vlerësimit e stimulimit të punonjësve, është e qartë për këdo se znj.D. , nuk mund të shkonte “jashtë shtetit” pa dëshirën e mirë të drejtuesit të institucionit, pavarësisht pozicionit të saj” ose “Pyetja që e ka përgjigjen brenda është “a do të shkonte nëse unë do isha duke e diskriminuar”, është i pabazuar në ligj dhe mënyrën e organizimit dhe funksionimit të shërbimit civil, i cili bazohet në parimin e meritës dhe profesionalizmit dhe jo mbi bazë të preferencave të titullarëve. Nga ana tjetër, këto deklarime të z.B. , tregojnë se, përtej kërkesave ligjore apo parimeve mbi bazën e të cilave duhet të funksionojë shërbimi civil, në institucionin e Autoritetit të Konkurrencës, administrimi dhe funksionimi i institucionit dhe menaxhimi i burimeve njerëzore, ka si bazë dëshirat apo preferencat e titullarit. Pra, qasja që rezulton nga këto deklarime të z. B. , është se, çdo gjë mund të bëhet nëse është dashmirsia ose preferenca e titullarit dhe asnjë nuk mund të bëhet nëse mungon dashmirsia apo preferenca e titullarit. Kjo, jo vetëm që nuk përbën një justifikim*

objektiv, por është një qasje që vjen në kundërshtim me rregullat dhe mënyrën e administrimit e funksionimit të shërbimit civil, por edhe administratës publike në tërësi.

Nëse Komisioni i Disiplinës, nuk mund të drejtohej nga një vartës i ankueses, e cila në detyrën e Sekretares së Përgjithshme përfaqësonte nëpunësin më të lartë në shërbimin civil në Autoritetin e Konkurrencës, drejtimi i Komisionit të Disiplinës, nga titullari i këtij institucioni, i cili po ashtu ka paraqitur kërkesën për fillimin e ecurisë disiplinore ndaj ankueses, nuk mund të mos ketë ndikimin e tij tek anëtarët e tjerë të Komisionit të Disiplinës, karriera apo ecuria e marrëdhënieve të tyre të punës është nën ndikimin e titullarit të institucionit. Nëse, titullari i institucionit, në mungesë të vullnetit të Komisionit të Konkurrencës, i cili është i vetmi autoritet që mund të disponojë në lidhje me marrëdhënien e punësimit të Sekretarit të Përgjithshëm, vendos për fillimin e ecurisë disiplinore ndaj ankueses, e cila ka mbajtur nivelin më të lartë në klasifikimin e pozicioneve të punës në shërbimin civil në Autoritetin e Konkurrencës, e bën të pamohueshëm faktin e ndikimit tek anëtarët e tjerë të Komisionit të Disiplinës, të cilët sipas z.B. , kanë vendosur në mënyrë unanime gjatë procedimit disiplinor në ngarkim të ankueses dhe marrjen e masës disiplinore për largimin nga shërbimi civil të znj.D.D.

Në rastin konkret argumentat dhe pretendimet e paraqitura nga ankuesja janë në përputhje me provat dhe informacionin e administruar dhe *krijojnë prezumimin se jemi para situatës së prezumimit të diskriminimit* nga z.D.B , Kryetar i Komisionit të Konkurrencës kundrejt ankueses, në lidhje me shkakun e diskriminimit të pretenduar prej saj në kuadër të “*çdo shkak tjetër/qendrimit të kundërt gjatë ushtrimit të kompetencave dhe përmbushjes së detyrave të përcaktuara me ligj*” dhe si pasojë barra e provës bie tek ky subjekt.

Në këto kushte, z.D.B , Kryetar i Komisionit të Konkurrencës, kishte barrën e provës që të provonte, ose që nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të diskriminimit dhe trajtimit të pafavorshëm, ose duke provuar se, megjithëse trajtimi i pafavorshëm është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, në mënyrë që hidhte poshtë pretendimet e ankueses se këto veprime janë kryer për shkak të shkakut diskriminues.

Z. D.B , Kryetar i Komisionit të Konkurrencës, nuk arriti të provojë se, trajtimi i padrejtë dhe i disfavorshëm të cilit i është nënshtruar ankuesja, nuk ka lidhje shkakësore me shkakun e diskriminimit të pretenduar nga ankuesja, ndërsa justifikimet e paraqitura rezultuan plotësisht të pabazuara. Në mungesë të një justifikimi objektiv dhe të arsyeshëm lidhur me veprimet e z.D.B , Kryetar i Komisionit të Konkurrencës, i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë të cilit i është nënshtruar ankuesja, për të gjitha momentet e konstatuara në këtë vendim, mbetet shkak i diskriminimit.

Në kushtet kur ndalimi i diskriminimit është një e drejtë kushtetuese, e detyrueshme për t’u zbatuar drejtpërsëdrejti nga institucionet, është një e drejtë e mbrojtur shprehimisht me ligjin nr. 10221 datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, është e natyrshme që kjo

e drejtë vendos detyrime negative për të ndërmarrë veprime në përputhje me të drejtën e punëmarrësve për mbrojtjen nga diskriminimi. Në rastin konkret, “*qendrimi i kundërt gjatë ushtrimit të kompetencave dhe përmbushjes së detyrave të përcaktuara me ligj*” nga ana e ankueses, përbën shkak diskriminues, sa kohë që z.D.B , Kryetar i Komisionit të Konkurrencës, ka dështuar të japë shpjegime alternative e të besueshme se, trajtimi i padrejtë dhe i disfavorshëm i ankueses nuk është bërë për shkakun e pretenduar ose është bërë në prani të rrethanave objektive dhe të justifikueshme.

Në referim të nenit 3, pikat 2 dhe 3, të LMD, Komisioneri, vlerëson se, z.D.B , Kryetar i Komisionit të Konkurrencës, e ka diskriminuar ankuesen në formën e diskriminimit të drejtëpërdrejtë dhe në formën e udhëzimit për të diskriminuar.

Direktivat e Bashkimit Evropian për mosdiskriminimin, nuk ofrojnë një përkufizim të “udhëzimit për të diskriminuar”, por përcaktojnë se “udhëzimi për diskriminim” përbën diskriminim¹⁵. Në mënyrë që të ketë vlerë në luftimin e praktikave diskriminuese “udhëzimi për të diskriminuar” nuk duhet të kufizohet vetëm në trajtimin e udhëzimeve që janë të detyrueshme në natyrë, por duhet të shtrihet për të kapur situata ku ka një preferencë të shprehur ose një inkurajim për t’i trajtuar individët në mënyrë më pak të favorshme për shkak në një prej shkaqeve të mbrojtura.¹⁶

“*Udhëzimi për të diskriminuar*” si formë diskriminimi është trajtuar nga GJEDNJ. Në çështjen *Bączkowski dhe të tjerët kundër Polonisë*, Kryetari i Bashkisë së Varshavës bëri deklaratë publike me natyrë homofobike, ku deklaronte se do të refuzonte lejimin e një marshimi për rritjen e ndërgjegjësimit për diskriminimin për shkak të orientimit seksual. Kur vendimi ishte përpara organit administrativ përkatës, leja u refuzua për arsye të tjera, të tilla si nevoja për parandalimin e përplasjeve ndërmjet demonstruesve. Në këtë rast, GJEDNJ konsideron se në vlerësimin e çështjes nuk mund të mos pranojë mendimet e forta personale të shprehura publikisht nga Kryetari i Bashkisë për çështje që lidhen drejtëpërdrejtë me vendimet në lidhje me ushtrimin e lirisë së tubimit. Ajo vëren se vendimet në fjalë u morën nga autoritetet komunale që vepronin në emër të kryetarit pasi ai i bëri të njohur opinionet e tij në lidhje me ushtrimin e lirisë së tubimit dhe “propagandës për homoseksualitetin”. Sipas GJEDNJ, mund të supozohet në mënyrë të arsyeshme që mendimet e Kryetarit të Bashkisë së Varshavës mund të kenë ndikuar në procesin e vendimmarrjes dhe si pasojë të shkelnin në mënyrë diskriminuese të drejtën e aplikantëve për lirinë e mbledhjes dhe kjo përbënte një shkelje të nenit 14 të KEDNJ-së në lidhje me nenin 11, për shkak të orientimit seksual.

¹⁵ Neni 2(4), Direktiva për Barazinë në Punësim; Neni 4(1), Direktiva e trajtimit të Barabartë Gjinor në lidhje me aksesin dhe ofrimin e Mallrave dhe Shërbimeve; Neni 2(2) (b), Direktiva për Barazinë Gjinore (e rishikuar); Neni 2(4), Direktiva për Barazinë Raciale.

¹⁶ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf

Komisioneri vlerëson se, z. D.B , Kryetar i Komisionit të Konkurencës, qoftë nëpërmjet veprimeve të tij të drejtëpërdrejta, ashtu edhe nëpërmjet mosveprimeve nga ana e tij, duke lejuar situata në kundërshtim me ligjin dhe duke mos marrë masa për të rregulluar veprimet dhe sjelljet në kundërshtim me ligjin, e ka ekspozuar ankuesen ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të disfavorshëm. Në cilësinë e titullarit të institucionit të Autoritetit të Konkurencës, Kryetarit të Komisionit të Konkurencës dhe Kryetarit të Komisionit të Disiplinës, z. B. , me veprimet dhe mosveprimet e tij të drejtëpërdrejta, së bashku me udhëzimet e shprehura të vendosura nëpër praktika të ndryshme, pavarësisht se nuk janë kërkesa të drejtëpërdrejta ndaj anëtarëve të Komisionit të Disiplinës apo njërive/personave të tjerë përgjegjës të ngarkuar nga ligji me kompetenca të caktuara në institucionin e Autoritetit të Konkurencës, tregojnë preferencë ose inkurajim për të trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të disfavoshme ankuesen.

Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se z.D.B , Kryetar i Komisionit të Konkurencës, ka diskriminuar ankuesen në të drejtën për punësim, për shkak të *“qendrimit të kundërt të mbajtur nga ankuesja gjatë ushtrimit të kompetencave dhe përmbushjes së detyrave të përcaktuara me ligj”*. Për rrjedhojë, z.D.B , Kryetar i Komisionit të Konkurencës, ka shkelur dispozitat e ligjit nr.10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar.

Bazuar në nenin 33, pika 10 të LMD, përcaktohet se: *“Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre”*. Në nenin 33, pika 12, të LMD-së, përcaktohet se: *“Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës”*

LMD, në nenin 33/10, nuk ka përcaktuar masat që duhen marrë për rregullimin e situatës diskriminuese, por e ka lënë në diskrecionin e Komisionerit. Pra, Komisioneri rast pas rasti, vendos se cilat janë rregullimet dhe masat që duhen marrë në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen efektive nga diskriminimi të personave që pretendojnë se janë viktima të diskriminimit. Ky ligj, nëpërmjet nenit 33/12, ka vendosur kriteret që duhet të ndjekë Komisioneri në përcaktimin e masës që ai jep nëpërmjet vendimeve të tij.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, masa e duhur për rregullimin e situatës diskriminuese është, marrja e masave për ndalimin e diskriminimit dhe mospërsëritjen e situatave të ngjashme, të cilat cenojnë zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, në të drejtën për punësim.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e diskriminimit të ankueses znj. D.D, në të drejtën për punësim, në formën e “*diskriminimit të drejtpërdrejtë*” dhe “*udhëzimit për diskriminim*”, për shkak të “*qendrimit të kundërt të mbajtur nga ankuesja gjatë ushtrimit të kompetencave dhe përmbushjes së detyrave të përcaktuara me ligj*”, nga ana e z. D.B , Kryetar i Komisionit të Konkurrencës.
2. Në referim të pikës 1, të këtij vendimi, z.D.B , Kryetar Komisionit të Konkurrencës, duhet të marrë masa për ndalimin e diskriminimit dhe mospërsëritjen e situatave të ngjashme ndaj ankueses znj. D.D, të cilat cenojnë zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, në të drejtën për punësim.
3. Konstatimin e mosdiskriminimit të ankueses znj. D.D, për shkak të gjendjes shëndetësore.
4. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijani për këtë vendim, z. D.B , Kryetar i Komisionit të Konkurrencës, të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.
5. Në referim të nenit 33, pika 11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010, “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
6. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku: Çdo shkak tjetër/ “qendrimit të kundërt të mbajtur nga ankuesja gjatë ushtrimit të kompetencave dhe përmbushjes së detyrave të përcaktuara me ligj”

Fusha: Punësim

Lloji i vendimit: Diskriminim

Forma: Diskriminim i drejtpërdrejt, Udhëzim për diskriminim